



Ndertojmë të Ardhme Transparente në Shqipëri

RAPORT MONITORIMIT





Ky raport u pergatit me iniciativen e shoqates “Intelektualet e rinj, Shprese”, në kuadër të projektit “Ndertojme të Ardhme Transparente në Shqipëri” me mbështetjen financiare të “The United Nations Democracy Fund” UNDEF.

Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e donatorit.

Përmbajtja

Hyrje	4
Metodologjia	5
Gjetjet e Raportit	6
Rekomandime	8

I – EDUKIMI

A. Baza ligjore	11
B. Arsimi në Bashkinë Shkodër	17
C. Problematikat e dala nga Forumet Civile	18
D. Monitorim: Mungesa e transparencës së buxhetit dhe shpenzimit të tij nga shkollat	20

II - EDUKIMI JOFORMAL, SPORTI DHE MOBILITETI RINOR

A. Baza ligjore	22
B. Aktivitetet për të rinjte në Bashkinë Shkodër	22

III - SHERBIMET SOCIALE

A. Baza Ligjore	26
B. Shërbimet sociale në Bashkinë Shkodër	31
C. Problematikat e dala nga Forumet Civile	32
D. Monitorimi i Qendrave Komunitare	33
E. Programi i Strehimi Social	34
F. Monitorim: Shperndarja e Banesave Sociale në Bashkinë Shkodër	35

IV - PAPUNËSIA

A. Baza Ligjore	38
B. Struktura e Punësimit në Bashkinë Shkodër	38
C. Zyra e Punësimit Shkodër	39
D. Programet që aplikon Bashkia Shkodër për zbutjen e papunësisë dhe nxitjen e punësimit dhe biznesit rinore	41

V – E DREJTA PËR INFORMIM DHE PJESEMMARRJA NË VENDIMARRJE

E DREJTA PËR INFORMIM

A. Baza Ligjore	43
B. Monitorimi i transparencës në Bashkinë Shkodër	43

PJESEMMARRJA NË VENDIMARRJE

A. Baza Ligjore	45
B. Monitorimi i Konsultimeve Publike në Bashkinë Shkodër	46
Anex Mbi Projektin “Ndërtojme të Ardhme Transparente në Shqipëri	50

Hyrje

Shqipëria ka ndërtuar një imazh publik pozitiv të përgatitjes së politikave kombëtare për të rinjtë, përfshi edhe pjesëmarrjen e tyre në politikë dhe vendim-marrje. Duke nisur nga viti 2005 e në vijim vendi gjithnjë ka miratuar një Strategji Kombëtare për të Rinjtë dhe respektivisht edhe një Plan Kombëtar Veprimi.

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (2015-2020) është një përpjekje ndër-sektorale për të ndërtuar një politikë të re për mbështetjen e të rinjve në Shqipëri. Plani cakton ndër të tjera si qëllim arritjen e gjashtë (6) objektivave strategjikë:

1. Nxitja dhe pjesëmarrja e të rinjve në proceset vendim-marrëse demokratike;
2. Nxitja e Punësimit të të Rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës;
3. Shëndeti, Sporti dhe Mjedisi;
4. Edukimi i të rinjve;
5. Mbrojtja Sociale;
6. Kultura dhe Vullnetarizmi;

Ndërkohe që ky plan është një ndërhyrje në nivel qendror, në nivelin e Qeverisjes Lokale rezulton se Bashkia Shkodër nuk ka një Plan Lokal për Rininë dhe në mungesë të këtij plani nuk mund të evidentojme qartë ndërhyrjet, aktivitetet dhe politikat që ndërmerr Bashkia Shkodër për rininë në nivel lokal.

Bazuar edhe në objektivat strategjike që janë përcaktuar në Planin Kombëtar të Veprimit për Rininë kemi indentifikuar 5 fusha ku jemi përqëndruar për të kryer monitorimin ndaj Bashkisë Shkodër. Këto fusha janë:

I – Edukimi

II – Edukimi Jo-formal, sporti dhe mobiliteti rinor

III – Shërbimet Sociale

IV – Papunësia

V- Pjesëmarrja në vendimarrje

Qëllimi i këtij raporti është të indentifikojë kompetencat e Bashkisë Shkodër në fushat e përcaktuara dhe monitorimi i zbatimit në praktike të shërbimeve të ofruara për aspekte të ndryshme.

Metodologjia

Aktivitetet monitoruese për hartimin e këtij raporti janë realizuar gjatë periudhës 15 Prill 2017-14 Korrik 2019. Në realizimin e tij metodologjia kryesore është ajo krahasuese dhe analitike duke analizuar legjislacionin në fuqi, që përcakton kompetencat dhe detyrat e Njesive të Qëverisjes Vendore në fushen e edukimit, shërbimeve sociale, kultures dhe sportit, papunësisë dhe pjesëmarrjes në vendimarrje. Studimi është i përqendruar në territorin e Bashkisë Shkodër.

Hartimi i këtij raporti është bërë i mundur nëpërmjet komunikimeve zyrtare me Bashkinë Shkodër, kontakteve të drejpërdrejta me drejtues dhe të zgjedhur vendorë, monitorimit të faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër www.bashkiashkoder.gov.al/.

Për të realizuar këtë studim janë dërguar kërkesa për informim kryesisht Bashkisë Shkodër për të siguruar informacionin zyrtar për monitorimet e realizuara. Gjithashtu nëpërmjet analizës së dokumenteve dhe akteve zyrtare të miratuar nga Bashkia Shkodër.

Gjetjet e Raportit

1. Shkollat në Bashkinë Shkodër rezultojnë të kenë probleme të ndryshme me infrastrukturën.
2. Kushtet higjeno-sanitare në shume shkolla nuk plotesojnë standartet minimale.
3. Diferencat në kushtet e shkollave mes shkollave në qytet dhe në zonat rurale janë evidente dhe rezultojnë se shkollat në zonat rurale kanë kushte më të papërshtatshme për zhvillimin e mesimit se sa shkollat e qytetit.
4. Sigurimi i ngrohjes në shkolla, megjithë investimin e Bashkisë Shkodër rezultojnë i pamjaftueshëm dhe prinderit në shumë raste janë ata që financojnë për sigurimin e ngrohjes për fëmijët e tyre.
5. Lloji kryesor i ngrohjes në shkolla në Bashkinë Shkodër rezultojnë të jetë ngrohja me gaz, që në disa raste të raportuara edhe në media kanë rrezikuar shëndetin e nxënësve. Problematike shfaqet edhe mosndezja e kaldajave dhe përdorimi i ngrohjes me gaz edhe në shkollat që është kryer investimi për vendosjen e ngrohjes qendrore. Këto problematika janë raportuar nga nxënësit e shkollave.
6. Mungesa e transparencës së fondeve që shkollat në Bashkinë Shkodër sigurojnë nga prinderit dhe nxënësit është një problematikë tjetër që rezultojnë nga ky raport. Shkollat nuk kanë llogari rrjedhese të pavaruara, nuk disponojnë asnjë mandate-arketimi, fature apo ndonjë mënyrë tjetër raportimi mbi mbledhjen e fondeve nga donacionet e prindërve dhe nxënësve dhe mënyrës si shpenzohen këto fonde.
7. Në shume shkolla mungojnë laboratorët e Fizikës, Kimisë, Biologjisë dhe salla e informatikës duke ulur cilësinë e arsimit, këto mungesa janë më të theksuara në shkollat e mesme në njësitë administrative.
8. Në disa shkolla mungojnë librat të detyrueshëm sipas kurrikulave mesimore në bibliotekën e shkolles, duke vështirësuar procesin mesimorë për nxënësit.
9. Krijimi i Qendres Rinore Publike nga Bashkia Shkodër vlerësohet maksimalisht duke qënë se u plotësua një nga pikat e Kontratës Sociale të lidhur me Kryetaren e Bashkisë Shkodër në 2015. Qendra Rinore është një hapësirë e re që i është shtuar të rinjve të qytetit të Shkodrës.
10. Ky raport evidenton mungesën të një programi të mirëfillt praktikash për studentet në Bashkisë Shkodër dhe institucioneve në varësi të saj. Në kushtet që në qytetin e Shkodrës ka një Kampus Universitar burimet njerezore dhe kryesisht të rinjtë nuk mungojnë. Por përdorimi eficient i burimeve njerezore nga Bashkia Shkodër është shumë i pakët. Praktikën për studentet janë vetëm një mënyrë e angazhimit të të rinjve, por përfshirja e të rinjve mund të bëhet edhe nepermjet nxitjes së vullnetarizmit në aktivitete të ndryshme socio-kulturore të zhvilluara nga Bashkia Shkodër dhe jo vetëm.

11. Mungesa e Planit Lokal të Veprimit për Rininë të miratuar nga Bashkia Shkodër evidentohet në këtë raport si një nga pikat e pa realizuara nga Kontrata Sociale 2015. Ky plan vlerësohet tepër i rëndësishëm për të rritur vemendjen e Bashkisë Shkodër ndaj të rinjve, duke parashikuar një program të qartë objektivash dhe aktiviteteve për të rinjtë.
12. Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar përmirësimit të infrastrukturës sportive në shkolla dhe në komunitet, organizimit i kampinateve sportive lokale dhe rajonale etj, si dhe organizimit të lojërave paraolimpike për personat me aftësi të kufizuara.
13. Mbrojta e mjedisit përmes iniciativave dhe sipërmarrjes rinore duhet të jetë në fokus të mbështetjes që Bashkia Shkodër duhet të japë për të rinjtë. Aktivitete të tilla si fushata ndërgjegjësimi dhe pastrimi, riciklimi i mbetjeve, organizimi panairëve të gjelbërta, mbështetja e sipërmarrjeve rinore me qëllim riciklimin e mbetjeve apo promovimin e zonave turistike dhe mbrojtjen e tyre.
14. Mungesa e informacionit nga qytetaret për shërbimet sociale, kryesisht në njësitë administrative, jo të gjithë kanë mundësi aksesit në internet, do të ishte e nevojshme të realizoheshin fushata informuese për shërbimet që ofrohen nga Bashkia Shkodër dhe menyrës së marrjes së këtyre shërbimeve.
15. Shpërndarja e jo e drejte e shërbimeve sociale në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, perceptimi i qytetareve kryesisht në njësitë administrative është se janë të lënë pas dore.
16. Krijimi i qendrave komunitare vlerësohet si një investim tepër i rëndësishëm i realizuar nga bashkia Shkodër në drejtim të rritjes së shërbimeve sociale ndaj personave në nevojë dhe grupeve të marginalizuara.
17. Evidentohet mungesa e transparencës nga qendrat komunitare mbi shërbimet, kategoritë që kanë përfituar shërbime, donatorëve, përbërjes së stafit etj.
18. Banesat sociale që administrojnë Bashkia Shkodër nuk janë shpërndarë të përfituesit sipas Akt-Marrëveshjes “Për Strehimin e Jetimeve në Qytetin e Shkodrës”.
19. Papunësia rezulton problematika kryesore që evidentojnë të rinjtë. Mungesa e mbështetjes nga Bashkia Shkodër për nxitjen e punësimit, mbështetjen e sipërmarrjeve rinore dhe biznesit të të rinjve evidentohet nga ky raport.
20. Nga ky raport është evidentuar se thirrjet për konsultime publike paraqesin shkelje të rënda ligjore si shkelja e afatit 20 dite pune mes thirrjes për konsultim dhe datës së zhvillimit të degjës publike apo mungesa e Koordinatorit të Konsultimeve Publike.
21. Ky raport evidenton se të rinjtë shprehin pak interes mbi politikën lokale dhe kanë po ashtu pak informacion mbi mundësinë e pjesëmarrjes në procesin e konsultimeve publike.

22. Të rinjte kanë pak interes për të marrë pjese në mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Dhe gjithashtu nuk ndihen të përfaqësuar në Këshillin Bashkiak.

23. Në Bashkinë Shkodër nuk ofrohen programet e tjera të strehimit social, pra, banesave sociale me qera, me kosto të ulët dhe trajtimi me bonus qeraje, kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së kapaciteteve të administratës në zbatimin e programeve sociale të strehimit, duke qënë një funksion i ri që i është ngarkuar Bashkive.

Rekomandime

Për Edukimin

- **Rritjen e investimeve nga Bashkia Shkodër për infrahuturën duke krijuar kushtet bazë për zhvillimin normal të procesit mesimor.**
- **Sigurimin e ngrohjes nëpërmjet ngrohjes qëndrore ose alternativave të tjera duke shmangur përdorimin e ngrohjes me gaz që përben rrezikshmëri të lartë për nxënësit.**
- **Investime për pajisjen e shkollave të mesme me laboratore fizike, kimie, biologjie, sallë kompjuterash etj. për zhvillimin e procesit mësimor cilësor.**
- **Sigurimin e librave (të përfshirë në kurrikula si të detyruar) për bibliotekat e shkollavë.**
- **Rritjen e transparencës mbi buxhetin që shkollat sigurojnë nga donacionet e prindërve dhe nxënësve.** Ushtrimi i një kontrolli të përshtatshëm nga Drejtoria e Arsimit dhe Bashkia Shkodër mbi përdorimin e këtyre fondeve. Si dhe krijimi i mekanizmave për raportimin të prindërit dhe nxënësit mbi përdorimin e donacioneve.

Për Edukimin jo-formal, sportin dhe mobilitetin rinor

- **Miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Rininë në Bashkinë Shkodër.** Kjo do të paraqiste një panorama të qartë të nevojave dhe problematikave që kanë të rinjte dhe do të krijohej një program i qartë me nderhyrje dhe aktivitete konkrete për zgjidhjen e problematikave që prekin të rinjtë në Bashkinë Shkodër.
- **Krijimin dhe publikimin e kalendarit/programit të Qendres Rinore Publike** në menyre që të jetë plotësisht funksionale.
- **Rritjen e transparencës së Qendrës Rinore Publike Atelie, duke publikuar, personat përgjegjës, aktivitetet, kalëndarin e tyre, llojit të financimit, donatorët etj.**

- **Zhvillimin e bashkëpunimeve nga Qendra Rinore Publike më Organizatat e Shoqërisë Civile që kanë në fokus të rinjtë**, kjo i shërben shtrirjes së ndikimit të një numër më të madh të rinjve që mund të përfitojnë nga aktivitete të ndryshme.
- **Nxitjen e vullnetarizmit dhe angazhimit të rinjve në aktivitete socio-kulturore.**

Për shërbimet social

- **Rritja e transparencës shërbimet që ofrohen në qendrat komunitare.** Publikimi i orarit të ofrimit të shërbimeve, kalendarit të aktiviteteve, personave përgjegjës dhe stafit që shërben etj.
- **Vendosja në funksion të plotë të ketyre objekteve (qendrave komunitare) duke krijuar shërbime për personat në nevojë dhe grupet e marginalizuara.** Ky rekomandim vjen si rrjedhojë e monitorimit që u realizua në qendrat komunitare në qytetin e Shkodrës ku rezultoj se nga 6 Qendra Komunitare ishin të hapura 4 prej tyre, 2 qendra komunitare rezultuan të mbyllura.
- **Realizimi i procedurave nga Bashkia Shkodër për shpërndarjen e banesave sociale të ish-konvikti të shkollës pyjore** sipas Akt-Marrëveshjes “Për Strehimin e Jetimeve në Qytetin e Shkodrës”.
- **Nga takimet rezultoi se në shumë çështje ka diferenca mes shërbimit që ofrohet në zonën urbane me atë në zonën rurale brenda territorit të bashkisë, prandaj autoritetet vendore duhet të analizojnë këto diferenca dhe në planet e tyre t’i adresojnë për t’i eliminuar gradualisht e për të respektuar të drejtën e banorëve për të marrë shërbime të njëjta pavarësisht nga vendbanimi i tyre.**

Për papunësinë

- **Krijimin e një zone me infrastrukturë të përshtatshme për hapjen dhe zhvillimin e bizneseve nga të rinjtë. Llojet e mbështetjes që mund të ofrohen janë:**
 - Ambjentet të ofrohen pa pagesë për një periudhë nga 1-2 vjeçare.
 - Përfshirjen nga taksat vendore të bizneseve që operojnë në këtë zonë.
 - Të mbështeten bizneset e kësaj zone me konsulence profesionale juridike, ekonomike si dhe nga fusha të tjera.
- **Krijimin e një fondi garancie nga Bashkia në mënyrë që të rinjtë të kenë lehtësira në marrjen e kredive tek Bankat e nivelit të dytë.**
 - Të vendoset në dispozicion të një Banke të nivelit të dytë, e cila do të përzgjidhet me konkurs, një fond garancie jo më i vogël se 10 Milion Lekë.
 - Të zhvillohen konkurse ku të rinjtë do kenë mundësinë të prezantojnë planin e tyre të biznesit, pranë një komisioni ekspertësh, në mënyrë që të përfitojnë nga ky fond.
- **Sigurimin e një programi praktikash profesionale për studentet në Bashkinë Shkodër dhe institucionet në varësi.**

Për të drejtën e informimit dhe pjesëmarrjen në vendimarrje

- **Praktika e mirë dhe progresi pozitiv i Bashkisë Shkodër në rritjen e transparencës së veprimtarisë së saj duhet që të pasohet tek njësitë administrative dhe sidomos tek shoqëritë publike të cilat janë nën varësin e Bashkisë Shkodër.**
- Niveli i ulët i informimit të komuniteteve mbi aktivitetin e bashkisë është një problematike e shfaqur në takimet me të rinjte dhe komunitetin. Edhe pjesa që banon në zonën qendrore të bashkisë në disa prej çështjeve objekt i vlerësimit nuk kishin informim mbi çfarë bën dhe çfarë ka arritur bashkia. Kjo pjesë u shpreh se përdor faqen e ueb të Bashkisë Shkodër për tu informuar për aktivitetin e saj, por nga verifikimi i kësaj faqeje rezultoi që një numër i konsiderueshëm rubrikash janë të pa përditësuara. Për këtë arsye rekomandojmë që bashkia të hartojë e zbatojë një strategji të mirë komunikimi me qëllim informimin e komuniteteve në të gjithë territorin e saj, si dhe përfshirjen e mendimit të tyre në çështjet me interes për ta.
- **Njoftimet për mbledhjet e këshillit bashkiak duhet të bëhen disa ditë më parë dhe publike.** Këshilli bashkiak duhet të ridimensionojë rolin e tij duke u përfshirë në jetën e komunitetit në takime me të shpeshta me ta, nga një anë për të kuptuar më mirë nevojat, prioritetet e komunitetit dhe mënyrën se si bashkia i adreson këto nevoja që kanalizohen në vendimet e këshillit, si dhe nga ana tjetër edhe për të eliminuar indiferentizmin që banorët shfaqin ndaj aktivitetit të këtij këshilli.
- **Sigurimi i pjesëmarrjes së të rinjve në vendimarrje** duhet të jetë një nga objektivat e Bashkisë Shkodër. Kjo mund të arrihet nga njëra anë duke zhvilluar degjesat publike në respektim të dispozitave ligjore dhe nga ana tjetër duke përdorur mekanizma për nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në degjesa publike. Konsultimi i akteve që ndikojnë të të rinjte në Bashkinë Shkodër në ambjentet universitare ose në Shkollat të mesme është një opsion për informimin e të rinjve, përfshirjen e tyre reale dhe marrjes së propozimeve dhe sugjerimeve nga të rinjtë.

I - EDUKIMI

A. Baza ligjore

Njesite e qeverisjes vendore kane keto funksione:

1. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.¹*
2. *Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.²*
3. *Regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë;³*
4. *Mbështetjen sipas kritereve të miratuara në Këshillat e Njësive Vendore:*
 - a) *nxënësit e familjeve në nevojë;*
 - b) *nxënësit me arritje të shkëlqyera;*
 - c) *punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës;*
 - d) *pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore.⁴*

***Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”
(Ndryshuar me ligjin nr. 56/2015, datë 28.5.2015)***

Ky ligj ka si objekt përcaktimin e parimeve bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.

Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive qënësive:

- a) *të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike;*
- b) *të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme;*
- c) *të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përbaljen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.*

Në arsimin parauniversitar nxënësit:

- a. *kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;*
- b. *përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;*
- c. *zhvillohen në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;*
- d. *zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;*
- e. *aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;*
- f. *aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës;*
- g. *zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes;*

¹ Pika 11, neni 23 i Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

² Pika 12, neni 23 i Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

³ Pika 3, neni 28 i Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

⁴ Pika 4, neni 28 i Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

h. përdorin teknologjitë e reja.⁵

Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.

Në shkollat publike arsimit i detyrueshëm dhe arsimit i mesëm i lartë janë falas.⁶

Në sistemin arsimor parauniversitar funksionojnë kopshtet, shkollat dhe institucionet plotësuese, të cilat janë publike ose private.⁷

Qendrat kulturore të fëmijëve janë institucione plotësuese, të cilat janë në varësi të njësive të qeverisjes vendore dhe hapen me vendim të Këshillit të Ministrave.⁸

Njësitë arsimore vendore u sigurojnë shërbim psiko-social nxënësve dhe punonjësve të institucioneve arsimore. Shërbimi psiko-social ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese, sipas nevojave të komunitetit shkollor.⁹

Sistemi Arsimor Parauniversitar administrohet në nivel qendror dhe lokal nga keto institucione:

1. Ministria e Arsimit e cila ka keto funksione:

- a) përgatitja e akteve ligjore dhe nënligjore të sistemit arsimor;
- b) zbatimi i i Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar;
- c) vlerësimi i cilësisë së shërbimit arsimor mbi bazën e treguesve;
- ç) kontrolli i zbatimit të ligjshmërisë dhe i përdorimit të fondeve në institucionet arsimore;
- d) hartimi dhe zbatimi i politikave të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë dhe akreditimi i programeve trajnuese;
- dh) sigurimi i mbështetjes profesionale nga institucione të specializuara, vendase ose të huaja, për kërkime dhe eksperimentime në fushën e arsimit;
- d) bashkëpunimi në fushën e arsimit me ministritë e linjës, njësitë e qeverisjes vendore dhe me organizmat tjerë qeveritarë ose joqeveritarë, të vendit ose të huaj;
- ë) publikimi për çdo vit shkollor i raportit të arritjeve të sistemit arsimor parauniversitar.

⁵ Neni 3 i Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"

⁶ Neni 5 i Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"

⁷ Neni 14 i Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"

⁸ Neni 15 i Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"

⁹ Neni 20 i Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"

Ministri është përgjegjës për realizimin e programit politik qeverisës në fushën e arsimit parauniversitar. Përveç detyrave të tjera të përcaktuara në këtë ligj, ministri:

- a) nxjerr urdhra dhe udhëzime për zbatimin e këtij ligji;
- b) propozon buxhetin e arsimit parauniversitar, sipas përcaktimeve në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- c) miraton dokumentacionin kurrikular, sipas përcaktimeve në këtë ligj;
- d) miraton strukturën e vitit shkollor;
- e) miraton ngarkesën mësimore, javore e vjetore, të punonjësve arsimorë dhe numrin e nxënësve për klasë për institucionet arsimore publike;
- f) miraton kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e regjistrimit të nxënësve në institucionet arsimore;
- g) miraton rregulloren tip të institucioneve arsimore;
- h) miraton kriteret për dhënien e certifikatave e të çmimeve dhe i lëshon ato për nxënësit dhe punonjësit e sistemit arsimor;
- i) nënshkruan me partnerët socialë kontratën kolektive të punës të nivelit të parë.

Inspektorati Shtetëror i Arsimit

Inspektorati Shtetëror i Arsimit është institucion në varësi të ministrit dhe funksionon në mbështetje të ligjit nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Funksionet kryesore të inspektoratit për arsimin parauniversitar janë:

- a) vlerësimi i cilësisë së shërbimit të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore;
- b) kontrollimi i pajtueshmërinë së veprimtarisë të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- c) këshillimi i drejtuesve dhe i punonjësve të institucioneve arsimore e të njësive arsimore vendore;
- d) informimi i ministrit, njësive arsimore vendore dhe institucioneve për gjetjet e inspektimeve arsimore, si dhe bërja publike e tyre;
- e) përhapja e praktikave të suksesshme të institucioneve arsimore dhe të njësive arsimore vendore.

Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar

Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar është organ këshillimor i ministrit për politikën e zhvillimit të arsimit parauniversitar dhe jep mendime për:

- 1. hartimin e strategjive, programeve kombëtare dhe akteve ligjore;
- 2. projektbuxhetin për arsimin parauniversitar;
- 3. çështje të tjera të politikave arsimore, me kërkesën e ministrit.

Njësiti arsimore vendore

Njësiti arsimore vendore janë drejtoritë arsimore, në nivel qarku, dhe zyrat arsimore, në nivel rrethi.

Njësia arsimore vendore:

- a) zbaton Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar;
- b) mbështetet institucionet arsimore për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor;
- c) bashkëpunon me njësinë bazë të qeverisjes vendore për planifikimin, realizimin e investimeve dhe mirëmbajtjen e institucioneve arsimore, si dhe për rastet e braktisjes së shkollës;
- d) siguron për institucionet arsimore publike mjetet mësimore, sipas formulës “për nxënës”.
- e) përdor fondin e veçantë të buxhetit vjetor për shpërblimin e punonjësve të institucioneve arsimore publike me arritje të shquara. Kriteret e përdorimit të këtij fondi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Njësia bazë e qeverisjes vendore¹⁰

Njësia bazë e qeverisjes vendore ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kompetencat kryesore të njësisë bazë të qeverisjes vendore janë:

- a) ndërtimi dhe rikonstrukcioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transfertat e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;
- b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe imjediseve të tyre;
- c) ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik;
- d) garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve arsimore publike.

Njësia bazë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë.

Njësia bazë e qeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e njësive arsimore vendore dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive vendore, mbështet:

- nxënësit e familjeve në nevojë;
- nxënësit me arritje të shkëlqyera;
- punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës;

¹⁰ Neni 28 i Ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”

- pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore.

Këshilli vendor i arsimit parauniversitar

Këshilli vendor i arsimit parauniversitar është organ këshillimor, në nivel qarku, për politikat e zhvillimit të arsimit parauniversitar, brenda juridiksionit territorial të qarkut. Këshilli vendor i arsimit parauniversitar krijohet me vendim të kryetarit të këshillit të qarkut dhe funksionon sipas rregullores së miratuar prej tij. Këshilli vendor i arsimit parauniversitar kryesohet nga kryetari i këshillit të qarkut dhe përbëhet nga përfaqësues të qeverisjes vendore dhe personalitete të njohura për kontribute në jetën publike. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit vendor të arsimit parauniversitar përcaktohen me udhëzim të ministrit.

Institucioni arsimor

Institucioni arsimor ka për detyrë krijimin e mjedisit miqësor për nxënësit dhe të mundësive që secili nxënës të shfaqë, të zhvillojë individualitetin dhe të realizojë potencialin e tij në përputhje me këtë ligj. Institucioni arsimor u ofron nxënësve mjediset dhe pajisjet për veprimtari sportive, kulturore e zbavitëse edhe pas orëve mësimore, si dhe në ditët e pushimit.

Komisioni i etikës dhe sjelljes në institucionin arsimor

Në institucionin arsimor funksionon komisioni i etikës dhe sjelljes, i përbërë nga mësues, prindër dhe nxënës. Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë ankesat e nxënësve, të prindërve e të punonjësve të institucionit ndaj shkeljeve të normave të etikës dhe të sjelljes dhe t'i propozojë drejtorit të institucionit masat përkatëse.

Bordi i institucionit arsimor

Çdo institucion arsimor ka bordin e tij të përbërë nga prindër, nxënës, mësues, përfaqësues të qeverisë vendore dhe të komunitetit. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor dhe i raporton për veprimtarinë e tij këshillit të prindërve të institucionit.

Detyrat kryesore të bordit janë:

- a) miraton planin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit;
- b) miraton planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat sigurohen nga institucioni;
- c) miraton kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor;
- d) merr pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të drejtorit të institucionit arsimor dhe të mësuesit.

Këshilli i mësuesve të institucionit arsimor, i cili ka në përbërje të gjithë mësuesit dhe kryesohet nga drejtori, është organ kolegjal këshillimor për drejtimin e veprimtarisë së institucionit.

Qeveria e nxënësve është organizëm që mbron dhe promovon të drejtat e nxënësve dhe ndihmon në mbarëvajtjen e shkollës. Ajo ngrihet dhe funksionon sipas udhëzimit të ministrit. Kryetari i qeverisë së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë zgjidhet nga nxënësit me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë. Qeveria e nxënësve përzgjedh mësuesin ndihmës. Në shkollë funksionojnë edhe organizime të tjera të nxënësve, të ngritura për interesat e tyre shkencore, kulturore dhe sportive.

Burimet për financimin e arsimit parauniversitar janë:

1. Buxheti i Shtetit;
2. të ardhurat e njërive të qeverisjes vendore;
3. dhurimet e sponsorizimet;
4. të ardhurat e përftuara nga institucionet arsimore;
5. të ardhura të tjera të ligjshme.

Financimi nga Buxheti i Shtetit planifikohet me formulën “për nxënës”, sipas treguesve tëveçantë të niveleve arsimore dhe kushteve të institucioneve arsimore publike. Në Buxhetin e Shtetit, për njësitë bazë të qeverisjes vendore, caktohet një fond “përnxënës”, i cili përdoret për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore publike, në përputhje me standardet e mirëmbajtjes për institucionet arsimore, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Mallra dhe shërbime të caktuara për institucionet arsimore publike njehsohen me formulën “për nxënës”, sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit dhe Ministrit të Financave.

Institucioni arsimor publik përfiton nga njësia bazë e qeverisjes vendore përkatëse një fond, sipas formulës “për nxënës”, që e përdor për shpenzime të vogla, për ndërhyrje emergjente, sipas kriterëve dhe procedurave të vendosura nga Këshilli i Ministrave. Nga buxheti i ministrisë veçohet një fond, fondi i cilësisë, për të cilin konkurrojnë institucionet arsimore publike me projekte për të përmirësuar cilësinë e shërbimit arsimor, sipas kriterëve të përcaktuara me udhëzim të ministrit dhe Ministrit të Financave. Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave miratojnë hapjen dhe mbylljen e llogarisë buxhetore të një institucioni arsimor publik. Institucionet arsimore publike të miratuara mbajnë llogari buxhetore pranë degës së thesarit në njësinë përkatëse arsimore vendore. Rregullat e administrimit financiar janë të njëjta me ato të institucioneve të tjera publike.

Mbledhja dhe përdorimi i fondeve financiare në institucionet arsimore publike

1. Institucionet arsimore publike, në pajtueshmëri me politikat e tyre, përfitojnë fonde financiare ose mbështetje materiale nga dhurues ose sponsorizues, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga ministri, në bashkëpunim me Ministrin e Financave. Dhurimet dhe sponsorizimet shërbejnë për të përmirësuar cilësinë e shërbimit arsimor.

2. Institucionet arsimore publike lejohen të sigurojnë të ardhura nga shërbime për të tretët, nëpërputhje me fushën e veprimtarisë së institucioneve. Fondet e siguruara nga shërbimet për të tretët përdoren sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

B. Arsimi në Bashkinë Shkodër

Zyra e Arsimit në Bashki trajton marrëdhëniet ekonomike në të gjithë institucionet e arsimit bazë (kopështe, shkolla 9 vjecare e të mesme, konvikte) që kanë të bëjnë me shpenzimet për rikonstruksione të pjesshme, mirëmbajtje të zakonshme etj. Organizon furnizimin me ushqime për kopështet me drekë dhe konviktet dhe furnizimin me lëndë djegëse për ngrohje. Kryen procedurat për miratimin e bursave për nxënësit konviktor dhe studentët që fillojnë vitin e parë të shkollës, mbështetur në vendimet e Këshillit të Ministrave. Aplikimet e kërkesave për burse paraqiten pranë zyrës së Arsimit gjithmonë mbasi të vijë plani i bursave nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Me ndarjen e re territoriale, Bashkia Shkodër duhet të sigurojë mirëmbajtjen e një numri të madh institucionesh arsimore për 11 njesitë administrative. (90 shkolla, 58 kopshte, 2 konvikte dhe 1 shkolle speciale).¹¹

Drejtoria Ekonomike e Arsimit administron 90 shkolla dhe 2 konvikte. Nga keto 28 shkolla në qytet dhe 62 në Njesitë Administrative. Numri i nxënësve që përfitojnë nga ky shërbim është rreth 17 200 nxënës nga të cilët 7 830 vajza. nga ku 11 227 nxënës në shkollat qytet dhe 5 973 nxënës në Njesitë administrative. Në konvikte përfitojnë nga ky shërbim 120 nxënës, 70 në konviktin e shkollës Industriale dhe 50 nxënës në konviktin e shkollës Artistike nga të cilët 4 janë vajza.¹²

Për administrimin e funksionimin e shkollave kërkohet mbështetja dhe financimi për shërbimet dhe mirëmbajtjen (*Materiale mbështetëse në shërbimin e nxënësve me konvikt, Materiale mbështetëse kuzhinë, Furnizime me ushqime, Materiale kancelarie, Materiale të ndryshme mbështetëse, Materiale hidraulike, Materiale për pastrim për ambjentet, Shërbim i ngrohjes me dru zjarri, Shërbim i ngrohjes dhe gatimit me gaz të lëngshëm, Shërbimi i ngrohjes dhe transportit me lëndë djegëse (naftë), Mirëmbajtjen e paisjeve dhe orendi, Mirëmbajtje e mjeteve të transportit, Shërbim i energjisë elektrike, Shërbim me ujë të pijshëm, Shërbimi internetit, Shërbimi postar, Materiale të ndryshme mbështetëse (xham, bojra), Materiale elektrike, Mirëmbajtjen e zakonshme të ndërtesave, Paisje dhe orendi për arsimin, Paisje teknike operacionale, Paisje elektronike, Sigurimin e ndërtesave, Shërbime për dizinfektim*).¹³

Sipas planit të zhvillimit të territorit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.27 datë 20.04.2017, Bashkia Shkodër ka një mbulim të mirë me kopshte, shkolla 9-vjecare dhe shkolla të mesme. Propozohet ndërtimi i kopshteve vetëm një në Shirokë dhe një Dajç duke qenë se aty mungojnë si dhe përmirësimi i kushteve në kopshtet ekzistuese. Në njesitë administrative Dajç dhe Mes propozohet ndërtimi i një shkolle të mesme si dhe përmirësimi i kushteve në shkollat e

¹¹ http://ëëë.bashkiashkoder.gov.al/ëeb/p9_arsimi_parauniversitar_dhe_edukimi_1423.pdf

¹² Burimi i informacionit, Bashkia Shkoder, për më shumë shiko:

http://ëëë.bashkiashkoder.gov.al/ëeb/p9_arsimi_parauniversitar_dhe_edukimi_1423.pdf

¹³ Po aty

tjera ekzistuese. Ndërsa përsa i përket rrezes së mbulimit me shkolla të mesme ato nuk shihet e arsyeshme të ndërtohen të reja, por vetëm të përmirësohen kushtet e atyre ekzistuese.¹⁴

Sipas ligjit për planifikimin e territorit në nenin 83 të tij, për strukturat publike për arsim rrezet e mbulimit janë vendosur duke marr pasasysh numrin e banorëve.

Për kopshtet:

1. Llogaritet një kopësht për çdo 1,500 banorë
2. Rrezja e mbulimit të kopshtit në vijë ajrore është 250-350 metra për zonat urbane dhe 500- 600 metra për zonat rurale.

Për shkollat fillore dhe 9-vjeçare:

1. Llogaritet një shkollë për çdo 6,000 banorë
2. Rrezja e shërbimit të shkollës në vijë ajrore është 500-600 metra në zonat rurale dhe 1,000-1,500 metra në zonat rurale.

Për shkollat e mesme:

1. Llogaritet një shkollë për cdo 9,000 banorë
2. Rrezja e mbulimit të shkollës në vijë ajrore është 1,000-1,500 metra në zonat urbane dhe 2,000-4,500 metra në zonat rurale.

C. Problematikat e dala nga Forumet Civile

1. Infrastruktura në shkolla ka qënë problematika kryesore e adresuar nga të rinjte në Forumet Civile. Kjo problematike manifestohet kryesisht me mungesën e palestrave, fushave sportive, laboreve, librave për biblioteke pjese të kurrikules, probleme me mirembajtjen e ambjentëve të jashtme.

Disa nga shkollat që kanë adresuar problematika janë:

Shkolla e mesme Oso Kuka pas investimit të bërë për rikonstrukcionin e godinës ka pasur ankesa për cilësinë e punimeve të kryera.

Shkolla e Mesme Dajç adreson problem të shumta si: ambjentet nuk janë të lyera, prizat e energjisë elektrike janë burim rreziku, oborri nuk ka asnjë mirembajtje (perjashto mirembajtjen vullnetare nga stafi i meuesve dhe nxënësit), disa ambjente të brendshme nuk janë funksionale dhe janë të ndotura duke përbërë burim infeksionesh të ndryshme, rrugapër te shkolla është e amortizuar, bëhet fjalë për një segment të shkurtër rruge.

Nga Shkolla Gur i zi u adresuan problematika kryesisht për ambjentet e jashtme, demtim të fasadës së shkollës dhe mos mirembajtja e oborrit dhe fushës sportive.

¹⁴ Pika 3.5.1 e Planit të Zhvillimit të Territorit Shkodër

2. Probleme me higjenen në shkolla – Shume Shkolla kanë adresuar si problem shqetësues higjenen në shkolla, një pjese e shkollave nuk kanë uje, tualetet nuk janë në kushte të mira etj.

3. Nevoja për përfshirje më të madhe të rinjve në proceset vendimarrëse – Të rinjtë shprehen se nuk ndihen të përfaqësuar dhe zëri i tyre nuk degjohet.

4. Mungesa e transparencës së buxhetit dhe shpenzimit të tij nga shkollat.

Foto nga Shkolla Luce Agraja, Dajç



D. Monitorim: Mungesa e transparencës së buxhetit dhe shpenzimit të tij nga shkollat.

Ne lidhje me kete pike, kemi derguar kërkesa për informim Drejtorisë Rajonale të Arsimit dhe 16 shkollave të mesme të Bashkisë Shkodër, në të cilën kemi kërkuar informacion mbi cfare bazë ligjore kerkojne nga nxënësit çdo vit një kuotë fikse (prej 1000 mij leke) nga çdo nxënës. Ketyre kerkesave zyrtarisht i ka kthyer pergjigje DAR-Shkoder me shkresen nr. 1305/1 Prot, datë 08/06/2018.

Sipas shkreses të DAR-Shkodër informohemi se *“...ju bëjmë më dije se nuk ka tarife pagese nga ana e nxënësve, e cila miratohet apo të jetë e detyrueshme për to për tu paguar në çdo fillim viti shkollor, po ka vetem të ardhura nga dhurimet e prindërve të nxënësve, bazuar në Udhëzimin nr. 29, datë 25.09.2007 të MASH, “Për Grumbullimin, ruajtjen dhe perdorimin e te ardhurave nga dhurimet e prindërve te nxenesve ne arsimin parauniversitar”*.

Ky udhëzim përcakton procedura dhe veprime të qarta për mbledhjen e të ardhurave nga prindërit.

Së pari merret një vendim për të kërkuar dhurime nga prindërit e nxënësve, kjo kërkesë shqyrtohet nga keshilli pedagogjik dhe miratohet nga bordi i shkollës. Keshilli pedagogjik pregatit listen me emertimin, njësinë, sasinë e materialeve ose shërbimet, si dhe vleren totale për të cilën kërkohen dhurime. Lista përfundimtare e votuar nga bordi firmoset nga kryetari i bordit të shkollës dhe drejtori i shkollës. Kjo listë afishohet në një mjedis të sallës së mesuesve për një muaj dhe ruhet në dokumentacionin e shkollës për 3 vjet.

Së dyti kontributi në lekë i prindërve si dhe donatoreve të ndryshëm duhet të jetë vullnetar. Gjatë një viti shkollor një familjeje/prindërve nuk i kërkohet më shumë se 1000 (njëmijë) lekë.

Se treti, ky udhëzim parashikon menyrën e arkëtimit dhe për këtë shkolla çel/hap një llogari rrjedhëse në një bankë në emrin e kryetarit të bordit dhe drejtorit të shkollës. Drejtori ngarkon një nendrejtor ose mesues që të grumbullojë lekët e dhuruara nga prindërit. Paratë dorëzohen drejtëpërdrejtë personit të ngarkuar ose derdhen në llogarinë rrjedhëse të shkollës. Prindi firmos një dokument në të cilin pohon dorëzimin e lekëve dhe personi në ngarkim firmos këtë dokument për marrjen në dorëzim. Dokumenti përmban datën e dorëzimit dhe sasinë e dorëzuar. Ky dokument ruhet në shkollë për 3 vjet.

Së katërti ky udhëzim përcakton përdorimin e parave që u jepen shkollës, për këtë shkolla krijon Komisionin e blerjeve të shkollës me 2-4 mesues si anëtar të cilët votohen nga Këshilli pedagogjik dhe një përfaqësues i qeverisë së nxënësve. Çdo blerje shoqërohet me fature të cilat ruhen në dokumentacionin e shkollës gjithashtu për 3 vjet.

Së pesti ky udhëzim përcakton raportimin dhe kontrollin. Drejtori i shkollës raporton me shkresë të posaçme te DAR/ZA. DAR/ZA informon zyrtarisht njësinë përkatëse të pushtetit vendor për të gjitha materialet ose shërbimet e kryera në shkollë në sajë të kontributit të prindërve. DAR/ZA

ushtron të drejtën e kontrollit mbi mënyren e përdorimit të parave si dhe mbi mirëmbajtjen e materialeve apo shërbimeve të kryera në shkollë nga dhurimet.

Koment:Shkollat nuk kanë llogari rrjedhëse të hapura sipas këtij udhëzimi. Kjo situatë nga njera anë ka sjellë mungesen e autonomisë ligjore reale së institucioneve arsimore për realizimin / arkëtimin e të ardhurave të siguruara nga prindërit, biznesi, si dhe donatorët e ligjshëm për plotësimin e nevojave të tyre, menaxhimin/mbartjen e fondeve, si dhe transferimin nga viti pasardhës. Si dhe nga ana tjetër lejon praktikën e grumbullimit të dhurimeve me mungesë të theksuar transparencë dhe pa asnjë dëshmi si mblidhen këto dhurime, si ruhen dhe si përdoren ato.

Nga 16 shkolla të mesme të Bashkisë Shkodër të cilave ju dergua kërkesë për informacion në lidhje bazën ligjore mbi të cilën kërkojnë nga nxënësit çdo vit një kuotë fikse (prej 1000 mij leke) nga çdo nxenës. Asnjë nga shkollat nuk ka dërguar zyrtarisht një informacion gjë që thëkson edhe njëhërë mungesen e transparencës në lidhje me dhurimet nga prindërit dhe gjithë procedurën e marrjës së këtyre dhurimeve dhe me tej përdorimit të tyre.

II - EDUKIMI JOFORMAL, SPORTI DHE MOBILITETI RINOR

A. Baza ligjore

Neni 25 i Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendor”, në Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese parashikon se:

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- 1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.*
- 2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.*
- 3. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e bibliotekave e të ambienteve për lexim, me qëllim edukimin e përgjithshëm të qytetarëve.*
- 4. Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.*

B. Aktivitetet për të rinjte në Bashkinë Shkodër

Qendra Rinore Publike Atelie

Në Kontraten Sociale të nenshkuar me datë 23/05/2015 nga znj.Voltana Ademi në atë kohe në cilësinë e Kandidatës për kryetare të Bashkisë Shkodër është parashikuar si një nga pikat e kontratës “Ngritja e një qendre multifunksionale rinore”. Kjo pikë e Kontratës Sociale është realizuar dhe sot kemi të ngritur Qëndren Rinore Publike Atelie. Ambjentet e qëndres rinore ofrojnë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme. Ne vlerësojmë që pasi qendra është ngritur sfida e vertete fillon tani dhe për këtë nevojitet një strategji dhe plan konkret aktivitetesh në menyrë që të vihen plotësisht në funksion ambjentet e krijuara.

Bashkia Shkodër duhet të vazhdojë promovimin e mundësive që ofrohen në Qëndren Rinore Atelie në menyrë që të nxitën të rinjte që të marrin pjesë.

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit online drejtuar të rinjve

Në Bashkinë Shkodër është krijuar një platform online për të rinjtë. Misioni i platformës është t’u ofrojë të rinjve të Bashkisë Shkodër dhe më gjerë, qasje të përmirësuar në informacion në lidhje me mundësitë që ofron tregu për punësim, studime, trajnime dhe kualifikime, etj. me një vëmendje të veçantë ndaj të rinjve të dizavantazhuar sidomos të rinjve me aftësi ndryshe. Kjo platformë publikon aktivitete të ndryshme që organizon Qendra Rinore Atelie.

Qendra Kulturore e Fëmijëve Shkodër (ish Shtëpia e pionierit) është institucion veprimtaria e të cilit fillon në muajin shtator 1947. Që nga fillimi e deri më sot në ambjentet e këtij institucioni

mësojnë stërviten e argëtohen çdo vit rreth 1500 fëmijë. Qëllimi kryesor i punës së këtij institucioni është zbulimi, rritja dhe kultivimi i prirjeve të fëmijëve në fushën e artit, sportit dhe shkencës.

Veprimtaria e Qendrës Kulturore të Fëmijëve është e ndarë në seksione:

- në atë të artit me 20 rrethetë instrumentistëve, të vokalit, të baletit, të pikturës të recituesve, të estradës etj.)
- të sportit me 15 rrethe (futboll, lojra me dorë, atletikë, pinpong, shah, gjimnastikë, boks, etj.)
- të seksionin tekniko-shkencor me 20- rrethe (gjuhët e huaja -anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht; matematikë, fizikë, biologut, etj.) Këto rrethe jashtëshkollore drejtohen nga specialistët më të mirë të këtyre fushave që ka qyteti ynë.

Krahas punës që bëhet me rrethet jashtëshkollore ky institucion zhvillon çdo vit një sërë veprimtarish. Prej 52 vitesh organizon Festivalin Mbarëshqipëtar të këngës për fëmijë ku marrin pjesë krijuesit dhe këngëtarët e vegjël më të mirë të të gjitha trevave Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe diasporë.

Përveç Festivalit Mbarëkombëtar Qendra Kulturore e Fëmijëve zhvillon çdo vit veprimtari interesante, të mbështetura financiarisht nga Bashkia, ku nga më kryesoret sipas seksioneve mund të përmendim:

- Bilbilat e vegjel të Shkodrës këndojnë-19 edicione
- Mbrëmje tradicionale e vitit të ri
- Konkursi i fjalës artistike Ekspozita vjetore e pikturës
- Premierë e estradës
- Kampionatet lokale të shahut dhe pinpongut Kampionatet pranverore në basketboll, volejboll dhe minifutboll, Kampionatet e vrapimit, Gara me bicikleta
- Zbavitimi me gjuhët e huaja, konkurse dhe olimpiada etj.

Një nga objektivat e Qeverisjes lokale duhet të jetë përmirësimi i mundësive për të rinjtë për të shpenzuar kohë të lire në mënyrë më cilësore në kuadër të së drejtës për të patur jetë cilësore. Këto do të jenë mundësi të cilat janë të lidhura me programe të cilat duhet të kenë synim specifik organizimin e kohës së lirë në aktivitete dhe veprimtari të fushave të ndryshme si ato sociale, kulturore, sportive, edukimi joformal, e të tjera.

Prandaj është i nevojshëm Hartimi i Planit Lokal për Rininë në të cilën të parashikohen një sërë aktivitete të formave të ndryshme.

Masivizimi i Kulturës Sportive tek të rinjtë duhet të jete një pike e rëndësishme ku duhet të drejtohet vemendja e qeverisjes lokale. Së pari, fokusi vendoset tek krijimi i klasave sportive, përmirësimi i infrastrukturës sportive në shkolla dhe në komunitet, organizimi i kampinateve

sportive rajonale etj. Një vëmendje e veçantë duhet kushtuar dhe organizimit të lojërave paraolimpike për personat me aftësi të kufizuara. Në Bashkinë Shkodër vëmendja ndaj sportit është e drejtuar në mbeshtetjen që i jepet Klubit të futbollit Vllaznia dhe Sport Klub Vllaznia, dhe pak vëmendje u është dhënë aktiviteteve sportive me natyrë ndërgjegjesuese apo aktiviteteve sportive joprofesioniste për të rinjtë.

Kampionati I lojërave me dorë mes shkollave të mesme të Bashkisë së Shkodrës është një nga aktivitetet sportive jo profesioniste të organizuara në vitin 2018 në Bashkinë Shkodër. Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit ka organizuar kampionatin e lojërave me dorë mes shkollave të Bashkisë Shkodër në Javën e Pavarësisë. Kampionati u zhvillua në datat 25 dhe 26 nëntor mes 4 shkollave, përkatësisht '28 Nëntori', 'Oso Kuka', 'Jordan Misja' dhe 'Shejnaze Juka'.

Koment:*Ajo që bie në sy është që shkollat e përfshira në këtë aktivitet janë vetëm nga qyteti i Shkodrës dhe rezultojnë se nuk janë përfshirë shkollat të mesme nga njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Rekomandohet që aktivitetet e këtij lloji dhe jo vetëm të përfshijnë njësitë administrative të cilët vuajnë më tepër mungesën e aktiviteteve kulturore dhe sportive. Lënia jashtë vëmendjes nga Bashkia Shkodër e Njësive Administrative të cilat janë zona rurale thekson më tej hendekun social-kulturor dhe ekonomik mes zonave rurale dhe qytetit të Shkodrës.*

Promovimi i lojës së shahut në Shkodër është gjithashtu një aktivitet me karakter sportive që është organizuar nga Bashkia Shkodër. Loja e shahut ka një traditë pozitive dhe të hershme në qytetin e Shkodrës. Tradicionalisht pranë klubit Vllaznia ka funksionuar ekipi i shahut për meshkuj dhe femra, të cilët kanë arritur rezultate sportive shumë të mira në vite, duke u shpallur, disa prej tyre edhe Kampion Kombëtar. Këtë vit kampionati u organizua në 3 faza. Faza e parë ishte për fëmijët e shkollave 9-vjecare, ku fituesit e kësaj faze kalonin në fazën tjetër dhe përballeshin me gjimnazistët. Faza e fundit dhe përfundimtare u zhvillua në Bashkinë Shkodër ku morën pjesë më të mirët e 2 fazave të para dhe veteranët e këtij sporti. Aktiviteti u përmbyll duke shpallur kampionin e qytetit.

Koment:*Sipas raportimit të realizimit të buxhetit të 2018 nga Bashkia Shkodër nuk ka informacione cilat janë shkollat e përfshira në këtë aktivitet por emertimi i aktivitetit "Promovimi i lojës së shahut në Shkodër" rezultojnë diferencues për pjesën tjetër të Bashkisë Shkodër që përbëhet edhe nga 10 njësi administrative të gjitha zona rurale. Aktivitetet e këtij lloji duhet të sigurojnë gjithëpërfshirjen dhe Bashkia Shkodër duhet t'ju japë vëmendje të gjithë territoreve që administrojnë.*

Mbrojta e mjedisit përmes iniciativave dhe sipërmarrjes rinore duhet të jetë në fokus të mbeshtetjes që Bashkia Shkodër duhet të japë për të rinjtë. Aktivitete të tilla si fushata ndërgjegjësimi dhe pastrimi, riciklimi i mbetjeve, organizimi panairëve të gjelbërta, mbeshtetja e

sipërmarrjeve rinore me qëllim riciklimin e mbetjeve apo promovimin e zonave turistike dhe mbrojtjen e tyre.

Foto nga Forumet Civile



III - SHERBIMET SOCIALE

A. Baza Ligjore

Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale

1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.
4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.¹⁵

Ndihma dhe Shërbimet Shoqërore

Bashkia nëpërmjet veprimeve dhe vendimeve bën të mundur ofrimin e:

- Ndhmës shoqërore;
- Shërbimeve shoqërore për individët dhe grupet në nevojë të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit e përfshirjen shoqërore, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore. “Shërbime shoqërore në komunitet” janë të gjitha llojet e shërbimeve shoqërore, publike dhe jopublike, që kryhen në nivel vendor në territorin nën juridiksionin e bashkisë ose komunës.¹⁶

Ndërhyrjet dhe detyrat e bashkisë realizohen nëpërmjet:

1. Shpërndarjes së ndihmës ekonomike;¹⁷

Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar ndihmë ekonomike paraqiten tek administratori shoqëror në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Neni 21 përcakton se “Këshilli bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik, të kryer nga administratori shoqëror. Këto familje në nevojë do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind dhe/ose me fonde të buxhetit vendor, sipas përcaktimeve që do të bëhen nga ministri përgjegjës për çështjet sociale.”

2. Pagesës për aftësinë e kufizuar;

Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

¹⁵ Neni 24 i Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendor”

¹⁶ Pika 15, neni 4, e Ligjit Nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”

¹⁷ Neni 20, i Ligjit Nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”

1. paraplegjikët dhe tetraplegjikët, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe mosha.
2. Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.
3. Personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës.

Kërkesa dhe dokumentacioni për të përfituar pagesë për personat me aftësi të kufizuar paraqiten tek administratori shoqëror në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Shërbime të kujdesit shoqëror

Shërbimet e kujdesit shoqëror janë një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror¹⁸. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshijnë këto grupe shoqërore:

- a) familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmijën që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për azilin;
- b) personat me aftësi të kufizuara;
- c) të rriturit, me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;
- ç) vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare;
- d) të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë;
- dh) të moshuarit në nevojë.

Në shërbimet shoqërore publike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi.

3.1 Shërbimeve të përkujdesit me personel të specializuar në shtëpi; “Shërbime në familje” janë shërbime të kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për kategoritë në nevojë, që e kanë të pamundur të marrin shërbime komunitare, ditore dhe rezidenciale.¹⁹

Shërbimi në familje është shërbim ndaj individit, person i vetëm, që jepet në shtëpi ose në familjen kujdestare. Shërbimi në familje u njihet fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, të cilët janë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga

¹⁸ Plka 1, neni 3 i Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e shqipërisë”

¹⁹ Plka 5, neni 3 i Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e shqipërisë”

familjarët apo kujdestari. Shërbimi në familje është një kombinim shërbimesh të kujdesit ditor që përfshin:

- a. furnizimin dhe shpërndarjen e ushqimeve të gatshme në shtëpi;
- b. furnizim të barnave apo furnizime të tjera;
- c. mbajtjen e higjienës personale;
- d. përmbushjen e nevojave të tjera të përditshme, sipas vlerësimit, rast pas rasti;
- e. mbështetjen psiko-sociale.

3.2 Shërbimeve të përkujdesit në qendra ditore, riintegruese dhe rehabilituese;

Shërbimet e kujdesit shoqëror, të ofruara kryesisht në qendra komunitare, ofrohen si shërbime të plota ditore ose gjysmëditore. Gjatë kohës së qëndrimit në qendrën komunitare garantohet siguria fizike, jepen shërbime për higjienën personale, kujdesin shëndetësor, edukimin, rehabilitimin psiko-social, kalimin e kohës së lirë në komunitet, fuqizimin e individit/familjes, si dhe çdo shërbim tjetër i nevojshëm, sipas nevojave të identifikuara të përfituesit.

Shërbimet në qendrat e zhvillimit janë shërbime komunitare që synojnë sigurimin dhe përmirësimin e statusit dhe cilësisë së jetës së individëve me aftësi të kufizuara, deri në 21 vjeç.

Llojet e shërbimeve, që ofrohen në qendrat e zhvillimit janë si më poshtë:

- a) terapi intensive psiko-sociale për aftësimin mendor dhe rehabilitimin social me qëllim integrimin në komunitet;
- b) shërbim psikomotor për aftësimin dhe përmirësimin e parametrave psikologjikë dhe të motorikës fine e globale;
- c) aftësim i parametrave fizikë;
- ç) shërbime të specializuara ortofonie për aftësimin e individëve me çrregullime të spektrit autik apo aftësisë për të komunikuar;
- d) terapi riaftësimi për punë;
- dh) terapi zhvillimi.

3.3 Strehëzat dhe strehimi i perkohshëm

Shërbimi në strehëza është shërbim i kujdesit shoqëror rezidencial i ofruar në mënyrë të perkohshme, që përfshin shërbimin e specializuar, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psiko-social, terapinë fizike, aktivitete profesionale, kalimin e kohës në komunitet, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit.

Përfituesit e shërbimit në streha janë:

- a) fëmija, i cili gjendet i pambikëqyrur nga prindërit, në rrezik, apo në situatë rruge;
- b) fëmija në nevojë të mbrojtjes së veçantë;
- c) i rrituri, ose i moshuari, i cili nuk ka vendbanim të përhershëm apo të perkohshëm dhe nuk është në gjendje të kujdeset për veten;
- ç) gratë dhe vajzat shtatzëna ose prindi i vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç;
- d) fëmijët dhe të rriturit, viktimat të dhunës në familje, abuzimit, viktimat të trafikimit apo viktimat të mundshme të trafikimit ose në rrezik potencial për jetën;

dh) fëmijët dhe të rriturit në rrezik për shkak të situatës shëndetësore, aftësisë së kufizuar, varësive nga droga ose alkooli apo përjashtimi social.

Strehimi i përkohshëm është një shërbim i ofruar ndaj individëve që ndodhen në rrethana të vështira dhe emergjente, deri në referimin e tyre të një shërbimi tjetër shoqëror. Përfituesit e këtij shërbimi nuk kalojnë në procesin e zakonshëm të vlerësimit të rastit, por vetëm referohen nëpërmjet punonjësit social.

3.4 Vendosjes së personave në qendra rezidenciale kur është e pamundur dhënia e ndihmës në kushtet e shtëpisë;

Shërbime në qendrat rezidenciale konsiderohen shërbimet e strehimit afatgjatë dhe të organizuar që u ofrohet kategorive në nevojë, për të cilat kujdesi në shtëpi nuk është i mundur. Vendosja e kategorive në nevojë në qendrat e kujdesit shoqëror bëhet me pëlqimin e individit ose përfaqësuesit të tij ligjor pas vlerësimit të gjendjes shoqërore, ekonomike dhe mjekësore të individit.

3.5 Ndjekjes së procedurave për caktimin e familjes kujdestare dhe të kujdestarëve.

Fëmijës së privuar në mënyrë të përkohshme/të përhershme nga mjedisi familjar ose kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis i sigurohet një përkujdesje alternative.

Përkujdesja alternative mund të jetë:

- a) vendosja në një familje alternative ose në një institucion të përkujdesjes për fëmijë;
- b) vendosja në një familje birësuese.

Shërbimet e përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror ofrohen në familjen kujdestare, sipas nevojave specifike të fëmijës, të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Procedura e evidentimit të familjes kujdestare organizohet dhe mbikëqyret nga strukturat e shërbimeve shoqërore të organeve të njësisë të qeverisjes vendore, të cilat ngrenë pranë tyre komisionet multidisiplinare për vlerësimin e rasteve. Organizimi dhe funksionimi i komisioneve multidisiplinare përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Kriteret, dokumentacioni dhe procedura që do të ndiqet nga strukturat e shërbimeve shoqërore të organeve të njësisë të qeverisjes vendore, për evidentimin e familjeve kujdestare, si dhe masa e financimit për shpenzimet e fëmijës të vendosur në familje kujdestare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Roli i Bashkisë

Për efekt të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar krijohet një strukturë përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, e cila, kryen këto detyra:

- Harton projektvendimin për familjet/ individët në nevojë, nën juridiksionin e bashkisë, për trajtim me ndihmë ekonomike dhe përllogarit fondin për mbulimin e tyre.
- Paraqet në këshillin bashkiak projektvendimin për propozimin për familjet/individët në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike dhe masën e përfitimit për këto familje/individë në nevojë.
- Harton projektvendimin për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar;

- Harton kërkesën për buxhetin dhe projektbuxhetin për vitin pasardhës për ndihmën ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuar.
- Grumbullon dhe përgatit informacione e statistika, të cilat i dërgon pranë strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, mban regjistrin e përfituesve dhe ndjek shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar.

Administratorët shoqërorë në bashki ose njësi administrative kanë për detyrë:

- a) të identifikojnë familjet që kanë nevojë për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar;
- b) të verifikojnë gjendjen shoqërore e ekonomike të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike dy herë në vit dhe, për familjet që shpallen përfituese për herë të parë, verifikimi i parë të kryhet brenda tre muajve;
- c) të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki të dhënat për familjet/individët në nevojë, që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuar;
- ç) të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar, si edhe të administrojnë këtë dokumentacion;
- d) të hartojnë kërkesën për bllok-ndihmën dhe fondin e pagesës së personave me aftësi të kufizuar çdo dymujor për njësi të vetëqeverisjes vendore;
- e) të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar;
- f) të hedhin në regjistrin elektronik kombëtar të dhënat e deklaruara nga aplikuesit për ndihmë ekonomike;
- g) të kontribuojnë në procesin e hartimit të projektvendimit për propozimin që familja/individët në nevojë të trajtohen me ndihmë ekonomike si dhe të listës së personave me aftësi të kufizuar;
- j) të raportojnë pranë bashkisë të dhëna statistikore për numrin dhe fondin për familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar.²⁰

Bashkia ofron dhe administron shërbimet e kujdesit shoqëror brenda territorit të saj:

- a) duke identifikuar nevojat;
- b) duke vlerësuar nevojat në bazë të hartës së vulnerabilitetit;
- c) duke hartuar planin social vendor;
- ç) duke programuar buxhetet vendore;
- d) duke planifikuar shportën bazë të shërbimeve shoqërore;
- dh) duke kontraktuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik;
- e) duke bashkërenduar me Shërbimin Social Shtetëror shërbimet e nevojshme të kujdesit shoqëror.

²⁰ Neni 31 i Ligjit Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"

Për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror. Pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit. Bashkia cakton nga një punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore për gjashtë deri në dhjetë mijë banorë.

Roli i punonjës social të njësisë së qeverisjes vendore

Punonjës socialë në njësinë e qeverisjes vendore janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit dhe kanë për detyrë:

1. të verifikojnë gjendjen shoqërore dhe ekonomike të individëve e të familjeve që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror nëpërmjet identifikimit të rasteve;
2. të ndihmojnë në përgatitjen e dokumentacionit për personat që aplikojnë për përfitimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nëpërmjet këshillimit, ndërmjetësimit dhe referimit në shërbimet sociale në nivel vendor, rajonal apo kombëtar;
3. të marrin pjesë në procesin e hartimit të planeve të kujdesit për personat që do të trajtohen apo të cilëve u refuzohen shërbimet e kujdesit shoqëror nëpërmjet vlerësimit, ndjekjes, monitorimit dhe mbylljes së rastit;
4. të përgatitin dokumentacionin dhe propozimet për miratim nga këshilli bashkiak;
5. të grumbullojnë dhe të hartojnë informacione, statistika dhe të mbajnë regjistrin e përfituesve, të ndjekin shpenzimet për personat që kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror;
6. të grumbullojnë informacione për rrjetet e shërbimeve publike dhe jopublike që veprojnë në territorin e bashkisë.

Pushteti qendror ndërvepron me bashkinë nëpërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në përcaktimin e:

1. Politikave të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore;
2. Zbatimin e politikave të sipërpërmendura;
3. Planifikimin e nevojave për ndihmë dhe shërbime shoqërore;
4. Programimin dhe kontrollin e fondeve;
5. Monitorimin e standareve për këto shërbime;
6. Përcaktimin e përfituesve të pagesës dhe ndihmës ekonomike.

B. Shërbimet sociale në Bashkinë Shkodër

Shërbimi Social në Bashki i jep përgjigje nevojave të territorit, të shpërndarjes së burimeve ekonomike që ka në dispozicion, si edhe vendosjes në rrjet të burimeve sociale dhe institucionale për të plotësuar nevojat e target grupeve të ndryshme. Ndër shërbimet e shumta që Bashkia ofron janë edhe Shërbimet Shoqërore që konsistojnë në formë të ndihmës ekonomike për shtresat në nevojë, të shërbimeve të përkujdesit social, rezidencial dhe komunitar.

Mbështetja për shërbimet sociale fokusohet në zbatimin e politikave sociale të përcaktuara nga Plan Social i Zonës, që është në proces miratimi në Këshillin Bashkiak dhe që përfaqëson një

instrument thelbësor nëpërmjet të cilit Bashkia e Shkodrës në bashkëpunim me të gjitha subjektet aktive, harton sistemin e integruar të ndërhyrjeve për shërbimet sociale.

Në Bashkinë Shkodër ka një strukturë përgjegjëse për shërbimet sociale e cila është Drejtoria e shërbimeve sociale, strehimit dhe shëndetit publik.

Kjo strukturë në Bashkinë Shkodër sipas informacionit zyrtarë administrojnë edhe shërbimin komunitar të ofruar nëpërmjet qendrave për familjen. Në bashkinë Shkodër funksionojnë 11 qendra komunitare nga të cilat, 6 në qytetin e Shkodrës dhe 5 në njësitë administrative.

Sipas informacionit zyrtarë me shkresë nr. 19927/1 datë 06/12/2018 këto qendra ofrojnë këto shërbime:

- Shërbime parashoqerore si informim, orientim, këshillim;
- Shërbim në familje;
- Mbështetje psikologjike
- Shërbime komunitare si mbrojtja e fëmijëve, fuqizimi ekonomik i familjes, programet për prindërimin pozitiv, klasa pas shkollës, shërbimet e kujdesit shëndetsor etj.

Të gjitha këto shërbime ofrohen për kategoritë vulnerabël, fëmijët, të rinjtë, personat me aftësi ndryshe, komuniteti Rom dhe Egjiptjan, të moshuarit etj.

C. Problematikat e dalë nga Forumet Civile

Forumet civile dhe grupet e punës për shërbimet sociale kanë nxjerrë këto problematika:

1. Mungesa e informacionit nga qytetarët për shërbimet sociale, kryesisht në njësitë administrative, jo të gjithë kanë mundësi akses në internet, do të ishte e nevojshme të realizoheshin fushata informuese për shërbimet që ofrohen nga Bashkia Shkodër dhe menyrës së marrjes së këtyre shërbimeve.
2. Shpërndarja e jo e drejtë e shërbimeve sociale në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, përceptimi i qytetarëve, kryesisht në njësitë administrative është se janë të lënë pas dore.
3. Dhuna në familje, Forcimi i sistemit të referimit për rastet e dhunës në familje;
4. Heqja e ndihmes ekonomike personave që kanë nevojë.
5. Mungesa e shërbimeve ditore për moshën e tretë.

Pas problematikave të evidentuara nga takimet me komunitetin dhe njëkohësisht nga grupet e punës nisëm monitorimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Shkodër. Monitorimi u realizua nëpërmjet dërgimit të kërkesave për informim, takimeve të drejtëpërdrejta, analizës së legjislatcionit dhe analizës së informacioneve zyrtare në faqën zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër.

D. Monitorimi i Qendrave Komunitare

Monitorimi synonte të identifikonte Shërbimet e ofruara në Qendrat Komunitare dhe kapacitetet organizative dhe material të këtyre qendrave.

Me date 22/11/2018, Shoqata “Intelektualet e rinj, Shprese” IRSH ndërmori një iniciative për monitorimin e qendrave komunitare “Për Familjen” në qytetin e Shkodrës nëpërmjet paraqitjes drejteperdrejte në ambjentet e qendrave komunitare. Qellimi i këtyre vizitave ishte monitorimi i shërbimeve që ofrohen në këto qendra nëpërmjet një pyetori të pregatitur nga Shoqata. Nga vëzhgimi ynë në terren u gjendëm para situatave dhe reagimeve të ndryshme, të cilat po jua paraqesim si mëposhte:

1. Në qendren komunitare nr. 1 në Kiras, funksiononte një kopësht për fëmijë. Në zyrën për qendren komunitare nuk kishte person të pranishëm dhe në derë ishte vendosur mbishkrimi se kjo qender funksionon në orarin 08:00-10:00 dhe 14:00-16:00.
2. Në qendren multifunksionale “Për Familjen” pranë shkollës Kole Idromeno, në orën 11:00, një nga personat e pranishëm në qender pasi komunikoj nëpërmjet telefonit me Drejtuesen e kësaj qendre, refuzoi të jepte informacione mbi shërbimet dhe aktivitetet që realizohen pranë qendres, duke deklaruar se kanë urdher të prerë për të mos dhënë informacione. Për më shumë, sipas saj duhej të drejtohem drejtorisë së Shërbimeve Sociale, pranë Bashkisë Shkodër.
3. Në qendren komunitare “Për Familjen” nr. 3, pranë Koolpingut, pas komunikimit nëpërmjet telefonit me përgjegjësen e qendres, na u komunikua se për të marrë informacion duhet të drejtohem drejtorisë së Shërbimeve Sociale, pranë Bashkisë Shkodër.
4. Qendra Komunitare nr. 4, pranë shtëpisë së të moshuarve u gjend e mbyllur dhe me një mbishkrim që është e hapur në orën 08:00-10:00.
5. Në qendren komunitare nr. 5 ishte e pranishme një nga personat e stafit që ndau disa informacione të pjesshme por nuk pranoi të përgjigjej pyetorit duke na thënë se për këtë duhet të drejtohem përgjegjësit të kësaj qendre, i cili nuk ishte i pranishëm.
6. Qendra Komunitare Për Familjen nr. 6 në orën 11:15 u gjend e mbyllur, dhe nga komunikimi me një person nga stafi i Kopeshtit aty pranë, u deklarua se nuk është parë njeri në këtë qender.

Qendrat komunitare janë ngritur si struktura për të ofruar shërbime sociale sa më pranë qytetareve dhe refuzimi për të dhënë informacion mbi shërbimet apo veprimet konkrete që realizohen në secilen qender komunitare përbën një shkelje të rëndë të transparencës së këtyre strukturave. Gjeja më minimale që mund të kërkojë një qytetar është të marrë informacion mbi shërbimet që ofrohen në një qender komunitare dhe kur ky informacion mungon ose refuzohet të jepet duhet të këtë një arsyetim ligjor që e mbështet këtë.

Monitorimi i Qendrave Komunitare të ngritura nga Bashkia Shkodër kishte qëllim që të vëzhgonte nga afër shërbimet komunitare si dhe të realizohej një pyetsori mbi kapacitetet e këtyre qendrave dhe shërbimet që ata ofrojnë. Nga vizita pranë këtyre qendrave dalim në këto përfundime:

1. Nga 6 Qendra Komunitare ishin të hapura 4 prej tyre, 2 qendra komunitare rezultuan të mbyllura.
2. Në qendrat të cilat ishin të hapura nuk kishte bashkëpunim dhe nuk pranuan të japin përgjigje mbi pyetjet që kishim parashikuar si staf. Theksojme se pyetjet kishin karakter njohes mbi shërbimet konkrete të ofruara dhe synonte një vlerësim të kapaciteteve materiale dhe profesionale që kishin këto qendra.
3. Qendrimi jo bashkëpunues i personave që shërbenin në qendra nuk ndihmoi vlerësimin sa më të drejtë të shërbimeve që ofron Bashkia Shkodër nëpërmjet këtyre qendrave. Nuk arritëm të marrim informacion bazë mbi shërbimet që ofrohen realisht në qendrat komunitare.
4. Pjesa më e madhe e personave që shërbenin në Qendrat Komunitare u shprehen se duhet të pajisemi me leje nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Shkodër për realizimin e pyetsorit dhe vazhdimin e komunikimit. Ky qëndrim vë në pikëpyetje të madhe funksionimin real të këtyre qendrave komunitare me kohe të plotë siç deklaroi Bashkia Shkodër në shkresat zyrtare.
5. Në këto qendra nuk kishte një aktivitet në proces për sa kohe qëndruam në qendër.

E. Programi i Strehimi Social

Në programet sociale të strehimit përfshihen²¹:

- a) programi i banesave sociale me qira;
- b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;
- c) programi i banesave me kosto të ulët;
- ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;
- d) programi për krijimin e banesave të përkohshme;
- dh) programi i banesave të specializuara.

Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore përcakton mënyrën e administrimit dhe të mirëmbajtjes së fondit publik të banesave sociale me qira. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të ngarkojnë strukturat përgjegjëse të tyre për të kryer funksionet menaxhuese për administrimin, në rastin kur kjo detyrë nuk i është ngarkuar një enti menaxhues.²²

Statusin e përfituesit nga programet sociale e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:

²¹ Pika 1, neni 11 i Ligjit Nr. 22/2018 "Për strehimin social"

²² Pika 1, neni 26 i Ligjit Nr. 22/2018 "Për strehimin social"

1. nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
2. kanë mbetur të pastrehë, si rezultat:
 - I) i fatkeqësive natyrore;
 - II) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë;
 - III) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve;
 - IV) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë;
 - V) familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj.

Përparësi në trajtimin me këtë program kanë:

- 1) personat me aftësi të kufizuara;
- 2) individët me statusin e jetimit;
- 3) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- 4) të moshuarit;
- 5) komuniteti rom;
- 6) komuniteti egjiptian;
- 7) Komunitetet e zonave rurale;
- 8) prindërit e vetëm;
- 9) viktimat të trafikimit /viktimat të mundshme të trafikimit;
- 10) viktimat të dhunës në familje

F. Monitorim: Shperndarja e Banesave Sociale në Bashkinë Shkodër

Bashkia Shkodër në programin Buxhetor Afatmesëm 2019 – 2021 ka parashikuar për vitin 2018:

- Rreth 45 të strehuar në banesat sociale me qera të rikonstruktuar pranë ish Konviktit të Shkollës Pyjore.
- Shërbime integruese dhe zhvilluese për rreth 45 jetimë dhe pjestarë të familjeve një prindërore të akomoduar në apartamente sociale funksionale dhe në administrim të Bashkisë së Shkodrës.²³
- 26 apartamente sociale funksionale dhe në administrim për jetimët dhe grate kryefamiljare pa përkrahje;

Nga diskutimet në grupet e punës rezultoj si problematike që banesat sociale nuk janë shperndare, megjithatë investimi është realizuar. Sipas informacioneve në rrugë jo zyrtare apartamentet sociale në Ish-konviktin e Shkollës Pyjore janë destinuar për tju shperndare

²³ Faqe 673 Programi Buxhetor Afatmesëm 2019 - 2021

përsonave me statusin e jetimit dhe grave kryefamiljare pa perkrashje sociale, kjo në bazë edhe të një marrëveshje të nënshkruar.

Pas kërkeses për informim drejtuar Bashkisë Shkodër nepermjet shkreses nr. 18699/1 Prot, datë 13/11/2018 arrihem të marrim kopje të Akt-Marreveshje Bashkëpunimi “Për Strehimin e Jetimeve në Qytetin e Shkodrës. Ku rezulton se Ministria E Zhvillimit Urban dhe Bashkia Shkodër me datë 07/03/2016 kanë lidhur këtë Akt-marreveshje duke marrë përsipër këto detyrime:

Ministria siguron fondet e nevojshme në buxhetin e saj të vitit 2016 për kryerjen e rikonstruksionit të godinës së ish-konviktit të shkollës pyjore Shkodër, për përshtatje në banesa sociale, për jetimet dhe familjet me një prind në situatë të veshtirë ekonomike-sociale.....

Bashkia Shkodër nga ana tjetër ka një sërë detyrimesh, ndër të tjera:

- 1. Bashkia vë në dispozicion godinen e ish-konviktit të shkollës pyjore Shkodër, e cila është në pronësi të saj, për strehimin e jetimeve dhe familjeve me një prind në situatë të veshtirë ekonomike-sociale në Bashkinë Shkodër.*
- 2. Bashkia nuk mund të ndryshojë destinacionin e godinës përveç për qëllime të strehimit social.*
- 3. Bashkia ka detyrimin që në këtë godinë të strehojë kategorinë e jetimëve të pa trajtuar me strehim dhe ata që banojnë aktualisht në godina të tjera të papërshtatshme brenda qytetit të Shkodrës dhe familjeve me një prind.....*
- 4. Bashkia menjëherë do të identifikojë personat e familjet e këtyre grupeve*
- 5. Bashkia miraton në Këshillin Bashkiak listën e personave që do të strehohen në këtë banesë, dy muaj përpara përfundimit të punimeve për rikonstruksionin e banesës.*

Sipas informacioneve Zyrtare nga Bashkia Shkodër, ka përfunduar rikonstruksioni i plotë i banesave sociale me qera të ndërtuar pranë ish konviktit të shkollës pyjore, për strehimin e kategorisë së jetimëve dhe familjeve një prindërore në situatë të vështirë social ekonomike. Është realizuar vlerësimi i kushteve social ekonomike i jetimëve që jetojnë në konviktet e shkollave. Jemi në pritje të miratimit të ndryshimit të destinacionit të godinës nga Këshilli i Ministrave dhe po punohet për realizimin e procedurave ligjore për përzgjedhjen dhe miratimin e përfituesve duke marrë parasysh ndryshimet e fundit të ligjit të ri nr. 22/2018 “ Për strehimin Social” që ka hyrë në fuqi në Nëntor 2018.

Sfida kryesore është që nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, të krijohet një mjedis mbështetës që do të ndihmojë dhe mbështesë për fuqizimin ekonomik, social dhe autonominë, këto shtresa vulnerabël që do të strehohen në këto banesa sociale.

Sfidë tjetër është aspekti menaxherial dhe bashkërendues i punës në këto banesa sociale me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator si premisë e rëndësishme për fuqizimin e personave të sistemuar aty, duke synuar një përfshirje sociale më të gjerë.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr 36, datë 30.05.2017 është miratuar Rregullorja “Për përbërjen dhe funksionimin e komisionit të strehimit në Bashkinë Shkodër”.

Pra, siç rezulton nga informacionet zyrtare në Vendimin nr. 26, datë 18/04/2019 të Këshillit të Bashkisë Shkodër “Për miratimin e Raportit të Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të vitit 2018 të Bashkisë Shkodër”, Programi i strehimit social për banesat sociale nuk është zbatuar plotësisht. Banesat Sociale të ndërtuara në Ish-Konviktin e Shkollës Pyjore Shkodër nuk kanë kaluar të përfuturit e përcaktuar në Akt-Marrëveshje.

Ndërsa për programet e tjera të strehimit social, pra, banesave sociale me qera, me kosto të ulët dhe trajtimi me bonus qeraje nuk gjejnë zbatim në Bashkinë Shkodër.

Bashkia Shkodër sjell si argument për mos aplikimin e këtyre programeve të strehimit social, mos plotësimin e ligjit me aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë procedurat dhe modalitetet e zbatimit të programeve sociale të strehimit. Duke marrë parasysh stafin e ri të angazhuar në çështjet e strehimit si një funksion i ri brënda drejtorisë vlerësohet si shumë e rëndësishme ngritja e kapaciteteve dhe krijimi i mundësisë së shkëmbimit të eksperiencave ndërmjet bashkive në mënyrë që të përmirësohet performanca e administratës në zbatimin e programeve sociale të strehimit, duke iu referuar nenit 74/2,3,4 sipas të cilit ministria përgjegjëse për strehimit brënda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji harton dhe miraton programet e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të administratës vendore.²⁴

²⁴ Vendimin nr. 26, datë 18/04/2019 të Këshillit të Bashkisë Shkodër “Për miratimin e Raportit të Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit të vitit 2018 të Bashkisë Shkodër”

IV - PAPUNËSIA

A. Baza Ligjore

Ligji Nr. 7995 Date 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar, përben kuadrin ligjor rregullator për nxitjen e punësimit në Shqipëri.

Qellimi i ligjit në lidhje me punësimin, formimin e kualifikimin profesional, Sherbimin Kombëtar të Punësimit dhe fondin e punësimit është ndjekja e politikave aktive të përgjithëshme për të mbështetur punësimin e plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht.

Shteti krijon dhe zhvillon zyrat e punësimit, që veprojnë nën kontrollin e një autoriteti qendror, për të përmbushur të drejtën e gjithë shtetasve të banorë në Shqipëri, për punësim fitimprurës, për të marrë keshillimin dhe kualifikimin profesional për çdo punësim të tillë dhe për të marrë mbështetje në të ardhura. . Politikat shtetërore të punësimit përfshijnë si masa për nxitjen e punësimit ashtu dhe sigurimin e mbështetjes në të ardhura.

Duke vlerësuar si duhet zhvillimin ekonomik, punësimin, dhe objektivat e tjera të politikave shtetërore, politikat aktive të shtetërore të punësimit synojnë të mbështesin punësimin e plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht, nëpërmjet sigurimit që:

- a. Të ketë punë për të gjithë ata që kërkojnë punë
- b. Një punë e tillë të jetë sa më produktive që të jetë e mundur
- c. Të ketë liri në zgjedhjen e punës dhe mundësitë me të plotë të mundshme për çdo person të punësuar që të kualifikohet dhe të përdorë aftësitë dhe dhuntitë e tij në një punë ku ai është përshtatur si duhet.

Në sasinë e të ardhurave përfshihen siguri i të ardhurave për papunësinë, si dhe mbështetja me të ardhura të kursanteve dhe e të papunësuarve prej një kohe të gjatë.

Për arritjen e këtyre synimeve, politikat shtetërore të punësimit duhet të zbatohen nëpërmjet zhvillimit:

- a. të programeve dhe projekteve aktive të tregut të punës
- b. të formimit profesional
- c. të riaftësimin profesional dhe formave të tjera të mbështetjes për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe
- d. të një sistemi të mbështetjes me të ardhura për të papunët.

B. Struktura e Punësimit në Bashkinë Shkodër:

Struktura e punësimit sipas sektorëve i referohet periudhës së nëntë muajit të vitit 2018:

- 25 % janë të punësuar në sektorin publik.
- 75 % janë të punësuar në sektorin privat.

Për nëntë muajin e vitit 2018 rezultoi se numri i të punësuarve në Bashkinë Shkodër është 27,753 persona, nga të cilat 7044 punonjës janë të punësuar në sektorin publik dhe 20,709 punonjës në sektorin privat. Numri më i madh i të punësuarve është në qytetin Shkodër, ndjekur nga Njësia Administrative Rrethina. Ndërsa njësitet administrative me numrin më të ulët të punësimit janë Postriba, Pulti, Shalë dhe Shosh. Megjithatë vlerësimi real i numrit të punësuarve

në vend vështirësohet për shkak të mosdeklarimit nga personat që ushtrojnë veprimtari ekonomike jobujqësore/bujqësore, por që nuk figurojnë të regjistruar. Prandaj mendohet se ky numër punësimi është edhe më i lartë. Një dukuri e tillë është e lidhur me lëvizjet migruese e cila ka sjellë një ulje të numrit të popullsisë në zonat rurale krahasuar me periudhën e fillim viteve '90, duke çuar në krijimin e qendrave urbane me dendësi popullsie deri në 230.18 banorë/km² (Bashkia Shkodër) dhe zona më pak tërheqëse për banim me dendësi prej 4.4 banorë/ km² (Shalë, Shosh, Pult). Kjo reflekton edhe përqendrimin ekonomik drejt qytetit Shkodër. Ndërveprim të dendur me qytetin e Shkodrës rezultojnë të kenë njësitë Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi etj. Papunësia:

Niveli i lartë i informalitetit, emigracioni, personat në moshë pune të cilët nuk figurojnë të regjistruar, vështirësojnë vlerësimin real të papunësisë në vend. Bazuar në të dhënat paraprake të marra nga Drejtoria Rajonale e Punësimit për nëntë mujorin e vitit 2018 rezulton se numri i të papunëve 19-64 vjeç është 5794 persona. Nga analiza e strukturës së papunësisë sipas grupmoshave, shkalla e papunësisë për popullsinë në moshë punë 19-39 vjeç është 36%, ndërsa përqindja e të papunëve të regjistruar të grupmoshës mbi 40 vjeç është më e lartë. Kjo ka lidhje me kërkesat në rritje të tregut të punës për mosha relativisht të reja. Për periudhën e nëntë mujorit të vitit 2018 rezultojnë të regjistruara si punë kërkuese të papuna 2850 femra ose 49% e totalit të të papunëve të regjistruara.

Nga kjo situatë, të rinjtë, edhe pse janë pjesa më produktive dhe aktive e popullsisë, vuajnë pasojat e papunësisë dhe mbi të gjitha mungesën e politikave që mbështesin fuqizimin dhe hapjen e bizneseve rinore dhe rrjedhimisht rrisin numrin e të rinjve të punësuar.

C. Zyra e Punësimit Shkodër

Zyra e Punësimit Shkodër është nën varësi të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe ofron shërbime publike për:

- punërkuesit dhe
- për punëdhënësit.

Shërbimet e punësimit ofrohen në bazë të Ligjit Nr. 7995 date 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar.

Shërbimet e Punësimit përfshijnë veprimtaritë e mëposhtme:

- a) Informim për vendet e lira të punës,
- b) Ndërmjetësim për punësim
- c) Këshillim dhe orientim për punë dhe profesion.

“Punëkërkuar” është çdo person i papunë, i disponueshëm për punësim, i cili paraqitet periodikisht në zyrën përkatese të punësimit, përfshirë edhe personat, të cilët janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar, por që kërkojnë një punë të re.

Shërbimet që ofrohen për punëkërkuar janë:

- Informacion dhe këshillim;
- Udhëzime për punësim, vlerësim të nevojave, zhvillim të karrierës/profesionit/Plan Aksioni për Punësim;
- Pjesëmarrje në një trajnim dhe ndërhyrje të tjera në tregun e punës.
- Shërbime ndërmjetësimi etj;
- Sistemi online për punëkërkuesit:
- Jep mundësinë që të krijojnë në mënyrë të pavarur një llogari në sistem;
- Jep mundësinë për të kërkuar vende të lira pune;
- Jep mundësinë e plotësimit të një CV në sistem sipas formatit online (model i ngjashëm me BE-në).

Shërbimet që ofrohen për punëdhëdhësit janë:

- Japim informacion mbi tregun e punës;
- Regjistrojmë dhe publikojmë vendet e lira të punës;
- Ofrojmë kandidatë të mundshëm për rekrutim;
- Japim informacion për programet e ndryshme të tregut të punës, si. psh, për programet e nxitjes së punësimit, të formimit dhe arsimit profesional etj;
- Sistemi online për punëdhëdhësit:
 - Jep mundësinë që të krijojnë në mënyrë të pavarur një llogari në sistem.
 - Të publikojë një vend të lirë pune.
 - Të kërkojë për punëkërkues të përshtatshëm si dhe t'i dergojë ftesë një punëkërkuesi.

Shërbimet e Migracionit

Shërbimet e migracionit ofrohen në dy drejtime kryesore:

1 . Në fushën e Imigrimit

Zbatohet Ligji 108/2013 datë 28.03.2013 “Për të Huajt” , i cili rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, punësimit, trajtimit dhe të daljes së të huajve nga Republika e Shqipërisë.

Subjekti i këtij Ligji janë të gjithë shtetasit e huaj që synojnë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë si qëllim transitimin, punësimin, studimin apo ripranimin. Këta të huaj trajtohen në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Në zbatim të Ligjit janë miratuar VKM me Nr .66 deri VKM Nr. 70, VKM Nr.74 deri VKM Nr. 85 datë 12/02/2014 “Për procedurat e pajisjes, refuzimit, ripërtëritjes dhe anulimit të Lejes së Punës “ sipas tipeve dhe dokumentacionit të përcaktuar në keto Vendime .

Sipas dipozitivave ligjore në fuqi, shërbimet ofrojnë mundësinë e pajisjes së të huajit me:

- a) Vertetimin e Deklarimit për Punësim, për shtetasit e BE-se, dhe zonës shengen, ose të SHBA,
- b) Leje pune të Tipit “ A” për Punëmarres, të Tipit “ B” për veprimtari të pavarur ekonomike , të Tipit “ C” për raste të vecanta, të tipit “D” leje të përhershme pune.

2.Në fushën e Emigrimit

Zbatohet Ligji Nr.9668, date 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve Shqiptare për motive punësimi”, i ndryshuar me Ligjin 10 389 , date 03.03.2011, si dhe Strategjia për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptare të Kthyer 2010-2015 dhe Plani i saj i veprimit si pjese e politikave kombëtare për migracionin.

Qëllimi është sigurimi i një kthimi të qëndrueshëm për emigrantët përmes mbështetjes së procesit të riintegrit pamvarësisht formës së kthimit. Ngritja dhe funksionimi i rrjetit të sporteve të Migracionit është pjesë e rëndësishme e mekanizmit të mbështetjes për riintegrim, në kuadër të së cilës gjen zbatim edhe Urdhëri Nr.84, datë 06.06.2011 “Për formën, përmbajtjen e “Regjistrimit për Emigrantët”.

Zyra e Punësimit Shkodër ka një staf punë prej 15(pesëmbëdhjetë) personash.
Me Adresë: Bulevardi” Zogu I-rë, Nr. 7, Shkodër.

D. Programet që aplikon Bashkia Shkodër për zbutjen e papunësisë dhe nxitjen e punësimit dhe biznesit rinor.

Neni 28 i Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendor, në Funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik vendor parashikon se:

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- 1. Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit e të programeve për zhvillimin ekonomik Vendor.*
- 2. Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregtisë.*
- 3. Mbështetjen për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike.*
- 4. Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacioni për bizneset, aktivitetet promovuese, vënia në dispozicion e aseteve publike etj.*
- 5. Publikimin e broshurave informative, krijimin e portaleve me profil ekonomik etj.*
- 6. Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.*

Papunësia mes të rinjëve në ditët e sotme është në nivele alarmante, për këtë arsye lind nevoja e mbështetjes nga qeverisja vendore, duke ndërhyrë me politikat e saj për të zbutur këtë fenomen mjaft negativ. **Nga te gjitha takimet e zhvilluara me te rinjte rezulton se punesimi eshte shqetesimi kryesore qe ato kane.** Ofrimi i mundesive per punesimi per te rinjte jo vetem qe do permiresonte statusin social-ekonomik te te rinjve por edhe do i jepte me teper mundesi zhvillimi qytetit tone prandaj Bashkia duhet ti kushtojë një vëmendje më të madhe punësimit të të rinjëve.

Krijimi i kushteve lehtësuese për punësimin dhe vetëpunësimin e të rinjëve do ishte një nxitje për keta të fundit. Te rinjve duhet ti ofrohen me teper kushte qe te zhvillohet kreativiteti i tyre nepermjet iniciativave sipermarrese, te cilat do i jepnin nje ritem tjeter zhvillimit ekonomik te qytetit.

Bashkia Shkodër aktualisht nuk ka programe specifike për nxitjen e punësimit të të rinjve. Aktivitetet që Bashkia Shkodër ka realizuar kanë qënë kryesisht me natyrë ndërgjegjësuere dhe promovuese, në formen e panairove.

Prandaj duke u nisur nga nevoja e te rinjve per me shume mundesi punesimi dhe duke shfrytesuar hapsirat ligjore qe ekzistojne dhe pasi kemi grumbulluar nevojat, kerkesat dhe sugjerimet e te rinjve rekomandojme ofrimin e këtyre ndrhyrjeve nga Bashkia Shkodër:

1. Krijimin e një zone me infrastrukturë të përshtatshme për hapjen dhe zhvillimin e bizneseve nga të rinjtë.

- *Ambjentet të ofrohen pa pagesë për nje periudhe nga 1-2 vjeçare.*
- *Përrjashtimin nga taksat vendore të bizneseve që operojnë në këtë zonë.*
- *Të mbështeten bizneset e kësaj zone me konsulence profesionale juridike, ekonomike si dhe nga fusha te tjera.*

2. Krijimin e një fondi garancie nga Bashkia në mënyrë që të rinjtë të kenë lehtësira në marrjen e kredive tek Bankat e nivelit te dytë.

- *Të vendoset në dispozicion të një Banke të nivelit te dyte, e cila do të përzgjidhet me konkurs, një fond garancie jo më i vogël se 10 Milion Lekë.*
- *Të zhvillohen konkurse ku të rinjtë do kenë mundësinë të prezantojnë planin e tyre të biznesit, pranë një komisioni ekspertësh, në mënyrë që të përfitojnë nga ky fond.*

V – E DREJTA PËR INFORMIM DHE PJESËMARRJA NË VENDIMARRJE

E DREJTA PËR INFORMIM

A. Baza Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Në Kushtetutën e RSH (Kushtetuta) është përfshirë një nen i posaçëm, Neni 23, mbi të drejtën e informimit: posaçërisht mbi informimin për veprimtarinë e administratës publike. Ky nen lexon:

“1. E drejta e informimit është e garantuar.

2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.

3. Kujto i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektiv”

Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

Ka si objekt organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre, e të organeve përkatëse. Në këtë ligj përcakohet detyrimi dhe përgjegjësia e njësive të qeverisjes vendore për transparencë, konsultim dhe pjesëmarrje qytetare gjatë vendimarrjes.

Ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Ligji 119/2014 mbart risi të cilat dukshëm synojnë të sigurojnë zbatimin praktik të së drejtës së informimit në Shqipëri, si dhe një sistem të llogaridhënies lidhur me të. Më të rëndësishmet ndër to janë:

- Garantimi i të drejtës për informim pa shpjeguar motivet;
- Përcaktimi i dy kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe me kërkesë;
- Hartimi dhe miratimi i programeve të transparencës, ku përfshihen kategoritë e informacionit publik pa kërkesë;
- Roli i koordinatorit për të drejtën e informimit dhe parashikimi i kompetencave të tij;
- Afate të reja për shqyrtimin e kërkesave për informim si dhe ankesave që depozitohen pranë Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- Parashikimet e rasteve të kufizimit të së drejtës për informim;
- Gjoka dhe sanksione administrative për të rritur llogaridhënien e autoriteteve publike .

B. Monitorimi i transparencës në Bashkinë Shkodër

Në muajin Prill 2016, Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” publikoj Raportin e parë mbi Transparencën në Bashkinë Shkodër i cili fokusohet në zbatimin e ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” si dhe në zhvillimin e procesit të konsultimit publik në zbatim të ligjit Nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Ky raport prezanton në mënyrë të detajuar progresin e konstatuar në drejtim të rritjes së nivelit të transparencës në përgjithësi në Bashkinë Shkodër si dhe përmbushjen e atyre kriterëve të

detyrueshme të përcaktuara në mënyrë të detajuar në ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” si dhe të sanksionuara në parimin e transparencës në ligjin Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” Gjatë gjithë periudhës Maj 2017 deri në Gusht 2018 shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” ka vazhduar monitorimin e nivelit të transparencës në Bashkinë Shkodër, nëpërmjet vëzhgimit të ëebsite zyrtarë të Bashkisë Shkodër si dhe nëpërmjet kërkesave për informim. Gjatë publikimit të raportit të parë në Prill të vitit 2016, rezultoi se Bashkia Shkodër zbatonte jo në mënyrën e duhur rreth 50% të kriterëve të përcaktuara në ligjin Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”. Gjatë monitorimit të progresit të arritur në lidhje me transparencën e Bashkisë Shkodër janë konstatuar hapa mjaft pozitivë në drejtim të rritjes së nivelit të transparencës ku faqja zyrtare e Bashkisë Shkodër jep informacion brenda standarteve të ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” duke realizuar hapa konkretë dhe të dukshëm në zbatim të kriterëve të përcaktuara në ligj dhe duke shënuar kështu një progres të dukshëm dhe të vlerësuar pozitivisht nga grupi i ekspertëve të cilët u angazhuan në hartimin e këtij progres raporti. Përdorimi i aplikacionit “Transparenca e buxhetit” si një gjetje inovatore ka shtuar mundësinë e qytetarëve, komunitetit, sektorit privat shoqërisë civile si dhe aktorëve të tjerë të monitorojnë zbatimin e buxhetit nga ana e Bashkisë Shkodër.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti synojnë që të inkurajojnë drejtuesit lokal në lidhje me rezultatet e arritura në drejtim të rritjes së nivelit të transparencës por edhe të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së transparencës duke ofruar informacionin për qytetarët në mënyrë sa më të thjeshtë dhe të kuptueshme duke ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisjen lokale si dhe në përmirësimin e cilësisë së qeverisjes dhe përmirësimit të shërbimeve të cilat ofrohen në nivel lokal.

Përfundime dhe rekomandime

Nga monitorimi i detyrimeve që rrjedhin prej legjislacionit në fuqi në lidhje me të drejtën e informimit dhe transparencën e institucioneve vendore, rezulton se në Bashkinë Shkodër janë bërë hapa pozitivë dhe ato reflektohen në vazhdimësi për efekt të respektimit të tyre, çka tregon për angazhim dhe përgjegjshmëri të këtyre zyrtarëve vendorë. Pavarësisht përmirësimeve në këtë drejtim, duhet theksuar se ende ka vend për të përmirësuar në respektimin e detyrimeve që u vendosen autoriteteve vendore për garantimin e së drejtës për informim.

Ky progres raport evidenton progresin e dukshëm pozitiv në drejtim të rritjes së transparencës në Bashkinë Shkodër siç u përmend në mënyrë më të detajuar mësipër. Për të patur një vazhdimësi në ruajtjen dhe ngritjen e nivelit të transparencës rekomandohet si mëposhtë:

- Praktika e mirë dhe progresi pozitiv i Bashkisë Shkodër në rritjen e transparencës së veprimtarisë së saj duhet që të pasohet tek njësitë administrative dhe sidomos tek shoqëritë publike të cilat janë nën varësinë e Bashkisë Shkodër.
- Duke qënë se jo të gjithë janë të familjarizuar me përdorimin e faqes zyrtare dhe të aksesimit të informacionit që ajo përmban, apo edhe dinë ta përdorin; Qytetarët preferojnë të drejtohen direkt pranë zyrave të institucioneve vendore, pasi hasin vështirësi dhe pengesa burokratike për hartimin e kërkesave për informacion ose e kanë më të

thjeshtë për të marrë informacion te drejtëpërdrejtë prandaj është e rëndësishme shtimi i sporteleve të informacionit dhe shërbimit në edhe ne njesite administrative të Bashkisë Shkodër.

- Mekanizmat dhe procedurat për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, si dhe për çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit public duhet te jene me te qarta per qytetaret dhe grupet e interesit.
- Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve mbi dispozitat ligjore që u garantojnë marrjen e informacionit edhe procedurat që duhet të ndjekin për realizimin e kësaj të drejte duhet te realizohet edhe nepermjet takimeve publike ne te gjithë territorin e Bashkise Shkoder.
- Informimi i vazhdueshëm i punonjësve të administrates dhe monitorimi i sjelljes së tyre, për sa lidhet me ndjekjen e procedurave dhe respektimin e afateve ligjore për dhënien e informacionit;
- Nxitja e profesionalizmit për të përmirësuar cilësinë dhe formën e dhënies së informacionit për qytetarët nepermjet forcimit te kapaciteteve të administratës për të përmbushur më së miri detyrimet me të cilat i ngarkon ligji për të drejtën e informimit;
- Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare në lidhje me informacionin e dhënë dhe programin e transparencës nga ana e Bashkise, si pjesë e detyrimit ligjor që ka.
- Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe projekte apo aktivitete të përbashkëta duke nxitur mekanizmat monitorues të transparencës;
- Duhet të krijohen forma të ndryshme të pjesëmarrjes së qytetareve online nëpërmjet blog/diskutime online apo zhvillimin e aplikacioneve mobile.

PJESËMARRJA NË VENDIMARRJE

A. Baza Ligjore

Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”

Ka si objekt organizimin dhe funksionimin e njesive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre, e të organeve përkatëse. Në këtë ligj përcakohet detyrimi dhe përgjegjësia e njesive të qeverisjes vendore për transparencë, konsultim dhe pjesëmarrje qytetare gjatë vendimarrjes.

Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”

Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik. Ai përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike. Ky ligj synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike.

Transparenca është veprimtaria e hapur e një organi publik për të informuar në lidhje me aktet me interes të lartë publik, me proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, që u siguron palëve të interesuara mundësinë për të marrë pjesë në këto procese.

Ligji ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, të realizuar në kohë dhe efektiv ndërmjet organeve publike qendrore dhe vendore dhe palëve të interesuara, në procesin e vendimmarrjes së projekt akteve si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik.

B. Monitorimi i Konsultimeve Publike në Bashkinë Shkodër

Pjesëmarrja e publikut në vendimarrje, është një e drejtë e qytetareve në kuadër të qeverisjes, por po ashtu, përbën edhe një detyrim qytetar për të kontribuar në drejtim të një qeverisjeje të mirë. Në të dyja rastet janë institucionet publike të çfarëdo lloj niveli, që duhet të mundësojnë dhe të garantojnë një pjesëmarrje reale, efektive dhe gjithëpërfshirëse të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimarrjen lokale.

Për të pasur një proces efektiv konsultimi publik duhet të përmbushen tre komponentët kryesorë të tij: njoftimi, konsultimi dhe pjesëmarrja.

Në muajin Prill 2016, Shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” publikoj raportin e parë mbi Transparençën në Bashkinë Shkodër duke u fokusuar në zbatimin e ligjit Nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe të ligjit Nr. 146/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” nga ku rezultoi se procesi i konsultimit publik nuk zhvillohej në mënyrë korrekte nga ana e Bashkisë Shkodër në pjesën më të madhe të dispozitave ligjore.

Për monitorimin e progresit të arritur është grumbulluar informacion nëpërmjet kërkesave për informim, pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë në procesin e konsultimeve publike, komunikimeve informale dhe vëzhgimit të faqes zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër.

Progres raporti analizon zbatimin e legjislacionit për konsultimet publike, progresin e bërë nga Bashkia Shkodër dhe evidenton problematikat në zbatimin e ligjit.

Dy prej problematikave kryesore të cilat rezultojnë në këtë progres raport janë:

- 1) mungesa e koordinatorit për njoftimet dhe konsultimet publike
- 2) mosrespektimi i afateve të njoftimeve për konsultimin publik.

Rubrika e krijuar në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër, për njoftimin e konsultimeve publike, konsiderohet progres pozitiv në përmirësimin e procesit të njoftimit të konsultimit publik në Bashkinë Shkodër. Po ashtu një tjetër zhvillim pozitiv krahasuar me raportin e mëparshëm është mbajtja e procesverbalit të takimeve konsultuese në formën e një dokumenti zyrtarë.

Gjetjet e monitorimit

1. Bashkia Shkodër në ëbsite të saj ka krijuar një rubrikë “Këshillim me publikun“ ku publikohen njoftimet për konsultime publike, në zbatim të detyrimeve të parashikuara në ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Koment: Krijimi i kësaj rubrike shënon progres pozitiv në krahasim me raportin e parë të monitorimit të realizuar në Prill të vitit 2016.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 828, datë 7.10.2015, “ Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrisë Elektronike për njoftimet dhe Konsultimet Publike, që i shërben rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes më të gjërë të publikut në vendimarrje, nëpërmjet krijimit të një portal online, dedikuar tërësisht, njoftimeve dhe konsultimeve publike nga autoritetet publike,

Koment: Vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave nuk është zbatuar duke qënë se ky portal nuk është i aksesueshëm nga Bashkia Shkodër.

3. Nga monitorimi rezulton se Bashkia Shkodër ka filluar të konsolidoj praktikën e publikimit të procesverbaleve të degjesave publike.

Koment: Publikimi i procesverbaleve shënon progres pozitiv në krahasim me raportin e parë të monitorimit të realizuar në Prill të vitit 2016 nga ku rezultonte se procesverbalet e takimeve konsultuese nuk mbaheshin në mënyrë të rregullt si dhe nuk publikoheshin

4. Koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, parashikohet nga dy ligje dhe një Vendim i Këshillit të Ministrave, konkretisht, ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrisë Elektronike për njoftimet dhe Konsultimet Publike“

Koment: Koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik sipas ligjit ka një rol të rëndësishëm, në procesin realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike dhe me detyra të përcaktuara qartë por Bashkia Shkodër akoma nuk ka caktuar një person që kryej detyrat e ngarkuara nga ligji.

5. Njoftimet për konsultimet publike sipas nenit 13 të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” duhet të përmbajnë informacione të rëndësishme të tilla si: arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë, afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre, adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin, vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij.

Koment: Nga këto 8 kritere të parashikuara vetëm 2 prej tyre zbatohen nga Bashkia Shkodër në njoftimet për konsultime publike të publikuara në ëbsite të këtij autoriteti publik ku në njoftim informacioni përmban vetëm datën dhe vendin e takimit.

6. Sipas nenit 15 të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet se koha e arsyeshme e cila duhet ti jepet palëve të interesuara për të dërguar pranë organit publik

vendimarrës komentet dhe rekomandimet e tyre duhet të jetë të paktën 20 ditë pune nga data e njoftimit.

Koment: Nga monitorimi i njoftimeve për konsultimet publike në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Shkodër rezulton se afati minimal prej 20 ditësh pune kohe ndërmjet publikimit dhe datës së konsultimit, shkelet në mënyrë të vazhdueshme.

7. Sipas nenit 20 të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet se organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimarrjes.

Koment: Nga monitorimi i realizuar nuk rezulton se janë publikuar raporte për transparencën në procesin e vendimarrjes të realizuara nga Bashkia Shkodër, për vitin 2017 dhe as për vitet paraardhëse. Këto raporte janë të detyrueshme dhe duhet të përfshijnë këto informacione, numri i akteve të miratuara nga organi publik, numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, numri i rekomandimeve dhe i komenteve të pranuar e të refuzuara gjatë procesit të vendimarrjes dhe numri i takimeve publike të organizuara.

Përfundime

- Nga monitorimi i detyrimeve që rrjedhin prej legjislacionit në fuqi në lidhje me njoftimet dhe konsultimet publike për Bashkinë Shkodër, janë konstatuar shume problematika të cilat i kemi pasqyruar në këtë raport.
- Nga monitorimi i Prillit të 2016, rezulton se ka pak ndryshime në zbatimin e ligjit për njoftimet dhe konsultimet publike. Nga 19 kritere të ligjit 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, të analizuara rezulton se vetëm 4 nga këto kritere plotësohen nga Bashkia Shkodër gjatë zhvillimit të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik. Nëse kjo pasqyrohet në përqindje rezulton se Bashkia Shkodër e zbaton ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, në masën 21%. Ndërsa në raport me progresin e arritur nga monitorimi i mëparshëm, për zbatimin e këtij ligji, rezulton se në Raportin e Prillit 2016, Bashkia Shkodër kishte të plotësuar 2 kritere nga 19 që parashikon ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, pasqyruar në përqindje, domethënë, 10.5%.
- Bashkia Shkodër përdor ëëbsite e saj për të publikuar njoftimet për konsultime publike, ky është një hap pozitiv për të rritur transparencën dhe për të rritur pjesëmarrjen në procesin vendimarrjes së qytetareve.
- Praktika e publikimit të procesverbaleve të takimeve për konsultimet publike vlerësohet, gjithashtu, si një hap pozitiv sepse në monitorimin e mëparshëm ishim në një situatë ku nuk mbaheshin procesverbale në menyre të rregullt nga drejtuesit vendorë. Nga monitorimi vërehet se ka mangësi në zbatimin korrekt të ligjit, sidomos në zbatimin e afateve dhe mungesën e koordinatorit përgjegjës për njoftimet dhe konsultimet publike.

Rekomandime

Në përfundim të monitorimit rekomandojmë:

- Bashkia Shkodër duhet të caktoj menjëherë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik;
- Të respektohet afati ligjor për dhënien e rekomandimeve, prej 20 ditësh punë, nga moment i publikimit të aktit duke i dhënë kohën e mjaftueshme personave të interesuar të japin rekomandime apo opinionet e tyre.
- Bashkia Shkodër për projektakte të rëndësishme të tilla si projekt-buxheti të vendosi afate më të gjata, deri në 40 ditë pune siç përcakton edhe ligji;
- Të plotësohen kriteret për njoftimin dhe konsultimet publike, duke përfshirë të gjithë elementet e domosdoshme të përcaktuar nga neni 13\1, i ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- Rekomandohet që në ëeb-site të Bashkisë Shkodër të bëhen ndryshime duke krijuar një rubrikë më të organizuar për Konsultimet Publike ku të përfshihet i gjithë informacioni i kërkuar ligjorë, si model krahasues mund të merret Bashkia Tiranë;
- Të zbatohen rregullat dhe kriteret e përcaktuara në VKM-së nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike”.
- Bashkia Shkodër duhet të kthej në praktike pune hartimin dhe publikimin e raporteve vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes ku të tregohet numri i akteve të miratuara nga organi publik, numri i përgjithshëm i rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, numri i rekomandimeve, komenteve të pranuara dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes si dhe numrin e takimeve publike të organizuara, duke qënë se në këtë mënyrë mund të vlerësohen rezultatet e konsultimeve publike të zhvilluara;
- Stafi i Bashkisë Shkodër duhet të trajnohet për një njohje dhe zbatim më të plotë dhe më të mirë të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në mënyrë që qytetarët, organizatat jofitimprurëse dhe çdo person i interesuar ti ofrohet mundësia e pjesëmarrjes në konsultimet publike, në mënyrë që të bëhen faktor në procesin e vendimmarrjes, nëpërmjet rekomandimeve dhe komenteve, por edhe që të informohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë për nismat vendimarrëse të Bashkisë Shkodër;

Anex


Mbi Projektin “Ndërtojme të Ardhme Transparente në Shqipëri

FOTO NGA AKTIVITETET

1. Organizimi i 12 Forumeve Civile



2. Organizimi i 12 Grupe Pune



3. Plani Lokal i Veprimit për Rininë



4. Ngritja e Parlamentit Rinore Shkodër

